



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME  
MINISTER/ URED PREMIJERA  
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA  
RAVNOPRAVNOST POLOVA/AGENCY FOR GENDER EQUALITY

# ÇFARË DUHET TË DIMË PËR BARAZINË GJINORE NË KOSOVË?



PRISHTINË, MAJ 2018

http://www.pdf-tools.com

Mbështetur nga Qeveria Suedeze - Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe  
Bashkëpunim Ndërkombëtare - SIDA



**NIRAS** **CPN**

<http://www.pdf-tools.com>

*...Sono una donna e una seria artista, e gradirei essere giudicata per quello.*

*...Jam grua dhe artiste serioze, e do të preferoja të gjykoresha, si e tillë.*

Maria Callas, soprano

## Shkurtesat

ABGJ - Agjencia për Barazi Gjinore

CEDAW - Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

KiE - Këshilli i Evropës

KE - Komisioni Evropian

EIGE - Instituti Evropian për Barazi Gjinore

BE - Bashkimi Evropian

FRA - Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore

DHBGJ - Dhuna me bazë gjinore

BGJ - Barazia Gjinore

Ligji për BGJ - Ligji për Barazi Gjinore

QRK - Qeveria e Republikës së Kosovës

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

IKAP - Instituti i Kosovës për Administratë Publike

PKBGJ - Programi i Kosovës për Barazi Gjinore

M&E - Monitorim dhe Vlerësim

MPBZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

MKK - Ministria për Komunitete dhe Kthim

MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

MD - Ministria e Diasporës

MZHE - Ministria e Zhvillimit Ekonomik

MIE - Ministria e Integrimit Evropian

MASHT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MF - Ministria e Financave

MPJ - Ministria e Punëve të Jashtme

MSH - Ministria e Shëndetësisë

MI - Ministria e Infrastrukturës

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

MD - Ministria e Drejtësisë

MFSK - Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MAP - Ministria e Administratës Publike

MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

OJQ - Organizata Jo Qeveritare

OECD - Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

ZKM - Zyra e Kryeministrat

SIDA - Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar TAIEX

- Instrumenti për asistencë teknike dhe shkëmbim të informacionit

UNESCO - Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim,

Shkencë, dhe Kulturë

UP - Universiteti i Prishtinë

## **Mohim**


Pikëpamjet në këtë publikim janë ato të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar SIDA.

# Përbajtja

Shpallje dhe falenderime

Lista e shkurtimeve

- I. Kujt i drejtohet ky publikim?
- II. Si ta përdorim këtë *vademecum*?
- III. Si vlerësohet një shoqëri nëse ka barazi gjinore ose jo?
- IV. Çfarëduhet të dimë për Agjensinë e Barazisë Gjinore dhe përse është i rëndësishëm roli i saj?
- V. Cila është puna e zyrtarëve për barazi gjinore në administratën publike [në nivel qendror dhe vendor]?
- VI. Çfarëjanë masat/ veprimet afirmuese dhe si lidhen ato me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore?
- VII. Përse stastistikat zyrtare i referohen seksit dhe jo gjinisë? Ku është dallimi?
- VIII. Instrumente ligjore kryesore që rregullojnë barazinë gjinore në Kosovë
- IX. Legjislationi ndërkombëtar mbi të drejtat e grave dhe barazinë gjinore
- X. Koncepte dhe përkufizime të nevojshme



## I. Hyrje: Kujt i drejtohet ky publikim?

Nëse e konsiderojmë domethënës për arritjen e barazisë mes gjinive, dhe në fakt mund ta vlerësojmë të tillë, roli i grave në udhëheqje nëbotën e sotme, ka njohur dimensione të reja. Premtuese? Është ende herët të konstatohet, për aq kohë sa paragjykimet dhe stereotipet mbizotërojnë jo vetëm në shprehitë kulturore të shoqërisë, në marrëdhëni e saj periferi - qendër, por për më tepër në vetë komunikimin mes gjinive. Perspektiva për një shoqëri që respekton barazinë [mes gjinive] në komunën, shtetin apo kontinentin ku banojmështë ende larg kur shikojmë se roli i vajzave dhe grave në tryezat e vendimmarrjes është [vetëm] numerik, dhe ende i brishtë. Mungesa e koncepteve të qarta mbi barazinë, diskriminimin, pjesëmarrjen dhe integritetin, të ndihmuara edhe nga shpërndarja e informacionit të gabuar, apo edhe keqpërdorimi i tij, pengojnë në mënyrë përcaktuese rolin e merituar të pjesëmarrjes së të dy gjinive, barazinë e tyre në qasje të informacionit, shërbimeve dhe mundësive. Ky botim, krah sqarimit të disa koncepteve të rëndësishme, ka si qëllim të na rikujtojë se barazia gjinore nuk mund të jetë thjesht një numër a përqindje po shumë më tepër. Si pjesë normale e jetës së përditshme, barazia nis me *normën*, si një standart a mënyrë të sjelluri me të cilën shumica prej nesh, shtetasve të arsimuar, jemi dakord. Prandaj ky botim, gjatë zbërthimit të përkufizimeve dhe standardeve ligjore mbi barazinë dhe gjininë në Kosovë, është në fakt një doracak për nëpunës dhe vendimmarrës, votues dhe taksapagues, sindikaliste dhe aktivistë, apo kushdo tjetër që banon në Kosovë, mbi të drejtat dhe detyrimet që ka secili prej nesh ndërsa kërkojmë të jetojmë, dhe ndërtojmë një shoqëri demokratike.

Zgjedhim ta quajmë *vademecum*, pasi kjo fjalë latine duket se mbështet më qartë dhe më fort qëllimin e këtij publikimi. (Nga latinishtja ‘vademecum’ do të thotë ‘eja me mua’ duke nënkuptuar në mënyrë figurative se ‘po të jap një dorë për ndihmë’)

I konceptuar për çdo lexues, pavarësisht gjinisë, moshës, kombësisë, fesë, arsimimit, origjinës dhe gjendjes shoqërore dhe ekonomike, ky publikim që nuk synon të jete një libër udhëzimesh të shkurtra tekniqe, përbledh një tërësi standartesh, të paraqitura si të drëjta, detyrime por edhe si ndëshkime për konsolidimin e një praktike tëmirë të respektimit tëbarazisë gjinore kudo në Kosovë: në vendimmarrje brenda institucioneve, në vendimmarrjen në interesin më të mirë të shtetasve, në informimin e tyre, në qasjen dhe shpërndarjen e shërbimeve, burimeve financiare, kujdesin e duhur shëndetësor, rregullimin e mardhënieve të punës.

Gjatë ndërtimit të një praktike të mirë, gabimet, por edhe mësimet janë të shumta. Një pjesë e mirë e standardeve të renditura në faqet vijuese i paraqesin këto, si rregullime, rishikime dhe plotësime në legjislacion dhe ndihmojnë në nxjerjen e mësimeve dhe synimeve të reja mbi barazinë.




## II. Si ta përdorim këtë publikim?

Në shërbim të lehtësimit të marrjes së informacionit në një burim të vetëm dhe kuptimit sa më të drejtë të normave dhe standarteve mbi barazinë gjinore në Kosovë, ky publikim që ju ofrojmështë skicuar në atë mënyrë që të jetë i dobishëm dhe të marrë vëmendjen e një kategorie sa më të gjerë lexuesish. Kuptohet, informacioni i përbledhur në faqet e tij, mund të gjendet edhe përmes burimeve dhe mjeteve alternative, por renditja sipas strukturës së paraqitur në faqet vijuese kërkon të zgjedhjet e mundshme shkallën e pritshme të vështirësisë në shqyrtimin e standarteve të barazisë dhe të përgjegjësisë institucionale. Megjithatë, jemi të bindur që lexuesit mund t'i lindin pikëpyetje dhe paqartësi mbi terminologjinë e trajtuar, çështje dhe koncepte të veçanta që përmban kuadri rregulator mbi barazinë gjinore, i përbledhur në këtëpublikim. Prandaj për ta bërë sa më të lehtë leximin e tij, sa më të qartë kuptimin dhe respektimin e koncepteve, standarteve dhe normave respektive, dhe sa më të dobishëm për të gjithëpërdorimin e publikimit, në këtë pjesë ju sqarojmë se si është strukturuar ky ‘vademecum’ në tërësi, dhe si ështëpërbledhur dhe renditur informacioni mbi ligjet që lidhen me barazinë gjinore në Kosovë. Në seksionin vijues paraqiten në mënyrë të përbledhur treguesit që ndihmojnë në matjen dhe vlerësimin e barazisë në shoqëri, bazuar në përkufizimin e kohezionit social dhe instrumenteve të zhvilluara nga kodifikimi i praktikave më të mira nga OECD. Gjithashtu në këtë seksion jepen në mënyrë të përbledhur edhe kriteret që duhen respektuar kur bëjmë vlerësim gjinor të politikave publike dhe legjislacionit. Seksioni 4 përshkruan atë që duhet të dimë për

Agjensinë për Barazisë Gjinore, duke u fokusuar në rolin e saj të rëndësishëm në promovimin e barazisë gjinore, monitorimin dhe përmirësimin e të gjithë kuadrit rregulator që lidhet me këtë fokus. Në seksionin 5 sqarohet se cila është puna e zyrtarëve/eve për barazi gjinore në administratën publike në nivel qendoror dmth në ministri dhe institacione të tjera të linjës, dhe në nivel vendor, pra në komunat e Kosovës. Kuadri politik i Qeverisë së Kosovës për barazinë gjinore dhe masat / veprimet afirmuese të tij të koordinuara dhe të monitoruara nën drejtimin e Agjensisë për Barazi Gjinore përbëhet në seksionin 6. Në seksionin 7 jepen detaje teknike në lidhje me standartet në mbledhjen e të dhënavë, klasifikimin e tyre për të kuptuar diskriminimin dhe/ose barazinë. Seksioni 8 përbën pjesën më të madhe të informacionit që ofron ky publikim. Si një pjesë mjaft esenciale dhe e rëndësishme, ai përbledh ligje kryesore që rregullojnë barazinë gjinore në Kosovë. Në dy seksionet tij të fundit 9 dhe 10 publikimi paraqet pjesë të legjislacionit ndërkombëtar aktualisht dhe drejpërdrejtë të zbatueshëm në Republikën e Kosovës mbi të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, si dhe një fjalorth me koncepte dhe përkufizime të nevojshme, të cilat janë përdorur në publikim.

Ky vademecum është hartuar fillimisht në gjuhën shqipe por struktura e tij është përshtatur në atë mënyrë që të lehtësojë leximin edhe në versionet e përkthyera në gjuhët e tjera zyrtare të Kosovës. Për konceptimin dhe përgatitjen e këtij publikimi janë përdorur burime zyrtare dhe ligjore të informacionit të cilat janë renditur në mënyrë tëdetajuar në fund në bibliografinë e tij.



### **III. Si vlerësohet një shoqëri nëse ka barazi gjinore ose jo?**

Nga praktika e mirë botërore mësojmë se një "shoqëri me barazi gjinore" është një shoqëri në të cilën burrat dhe gratë, si anëtarë të barabartë të saj, kanë mundësi të marrin pjesë në të gjitha llojet e aktiviteteve shoqërore sipas dëshirës së tyre, tégëzojnë po aq përfitime politike, ekonomike dhe kulturore, si dhe të ndajnë përgjegjësi. Në një shoqëri të tillë, të drejtat e njeriut, të burrave dhe grave respektohen në mënyrë të barabartë. Gratë që dëshirojnë një rol aktiv në shoqëri mund të marrin pjesë në aktivitete sipas zgjedhjes së tyre, ndërsa burrat mund të gëzojnë një jetë të përbushur në shtëpi dhe në komunitet. Një shoqëri e barabartë në gjini është një shoqëri e ndërtuar nga burrat dhe gratë si partnerë të barabartë.

Realizimi i një shoqërie me të vërtetë të shëndetshme dhe kohezive varet nga krijimi i një kuadri social që lejon individët të zgjedhin stile të ndryshme jetese pa marrë parasysh gjininë e tyre, dhe pa u kufizuar nga role të tillë të ngurta stereotipike gjinore që supozojnë se rritja e fëmijëve dhe kujdesi ndaj tyre janë ekskluzivisht detyrë e grave, ndërsa burrat janë punëtorët, taksapaguesit dhe financuesit e pensioneve. Megjithatë në realitet, megjithëse barazia gjinore është pak a shumë e arritur në shumë vende në kontinent, sai përket legjislacioneve pjesëmarrja e grave në proceset e politikës dhe vendimmarres mbetet e pamjaftueshme, e gratë ende kanë pak mundësi për të realizuar potencialin e tyre të plotë. Tendenca tradicionale për të parë pjesëmarrjen e burravenë punët e shtëpisë dhe

edukimin e fëmijëve si një sjellje të panjohur, dhe barra e rëndë e punëve të shtëpisë, kujdesit për fëmijët dhe shëndetin e tyre si obligim vetëm i grave në Kosovë dëshmon për faktin se shoqëria jonëka ende rrugë të gjatë përpara që të mbërrije ritmin e vendeve të tjera në aspektin e barazisë gjinore.

Ndaj, secilit prej nesh, i duhet të rishikojë nocionet e paragjykuara të roleve të bazuara në gjini, në mënyrë që të mund të ndërtojmënjë shoqëri ku burrat dhe gratë mund të marrin pjesë së bashku në politikë, në vendin e punës dhe në shtëpi dhe të frymëzojmë jetët toname emocione dhe asiprata përbushëse. Po të rifrazojmë Edmund Burken, një rishikim i tillë, i plotë dhe gjithëpërfshirës ndodh “atëherëkur gratë dhe burrat, të gjithë bashkë-si shtetas të mirë vendosin të marrin pjesë nëmënyrë të vazhdueshme dhe aktive në diskutimin dhe monitorimin e atyre çështjeve të rëndësishme për ta në arritjen e barazisë, përgjegjshmërisë dhe respektimit të të drejtave tëçdo individi pavarësisht gjinisë”. Instrumentet e nevojshme për të realizuar efektivisht këto imperativa janë lexojmë në korniza të ndryshme politike ndërkombëtare, rajonale dhe vendore, por është detyra jonë si vendimmarres, dhe konkretisht e Agjensisëpër Barazi Gjinore në vlerësimin e përshtatshmërisë së këtyre instrumenteve për t'u zbatuar në një mjedis social si ky i yni, duke mos sforcuar arritjen e rezultatetve vetëm formalisht. Pra krijimin e modeleve të sjelljes pozitive, përmes një përputhje artificiale dhe teorike me standartet.

Në një vështrim të shpejtë, duke zbatuar një qasje në analogji me prioritetet e përcaktuara në vendet e tjera të rajonit, më poshtë janë renditur disa objektiva strategjikë dhe treguesit përkatës që synojnë barazinë gjinore dhe kohezionin social.

## *Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshiem të Organizatës së Kombeve të Bashkuara*

Objktivi 5. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave

5.1 Dhënia fund e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe vajzave në të gjithë botën.

5.2 Eliminimi i të gjitha formave të dhunës kundër të gjitha grave dhe vajzave në sferat publike dhe private, duke përfshirë trafikimin, shfrytëzimin seksual dhe llojet e tjera të shfrytëzimit.

5.3 Eliminimi i praktikave të dëmshme, të tilla si martesat e fëmijëve, të hershme dhe me detyrim, dhe i gjyqtimit gjenital të femrave.

5.4 Njohja dhe vlerësimi i kujdesit të papaguar dhe punës në shtëpi përmes ofrimit të shërbimeve publike, infrastrukturës dhe politikave të mbrojtjes sociale, dhe promovimi i përgjegjësive të përbashkëta brenda familjes sipas specifikave kombëtare.

5.5 Sigurimi i pjesëmarrjes së plotë dhe efektive dhe i mundësive të barabarta për lidership të grave në të gjitha nivelet e vendimarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike.

5.6 Sigurimi i qasjes universale në shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejta riprodhuese siç është rënë dakord me Programin e Masave të Konferencës Ndërkombëtare për

Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Platformës së Pekinit për Veprim dhe dokumentet e rezultateve të konferencave të analizës.

5.a Ndërmarrja e reformave për t'u dhënë grave të drejta të barabarta në burime ekonomike, si dhe qasje në pronësinë dhe kontrollin mbi token dhe forma të tjera të pronës, shërbime financiare, trashëgimi dhe burime natyrore, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

5.b Rritja e përdorimit të teknologjisë mundësuese, në veçanti teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për të promovuar fuqizimin e grave.

5.c Miratimi dhe forcimi i zbatimit të politikave të shëndosha për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjithagrave dhe vajzave në të gjitha nivelet.

### *Treguesit e kohezionit social të Organizatës për Zhvillin dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD)*

Kohezioni social shpesh identifikohet si një objektiv mbizotërues i politikave sociale në vende të ndryshme të OECD-së. Përderisa nuk ka një marrëveshje reale për atë se çfarë do të thotë ky term, ekzistojnë një sërë simptomash që paralajmërojnë mungesën e kohezionit social ose krizën e tij. Kohezioni social është lehtësisht pozitivisht i dukshëm, kur mësojmë masën në të cilën njerëzit marrin pjesë në komunitetet e tyre ose besojnë njëri-tjetrin.

Kënaqësia e jetës përcaktohet jo vetëm nga zhvillimi ekonomik, por edhe nga përvojat e ndryshme dhe kushtet e jetesës. Shkalla e besimit që qytetarët kanë në institucionet politike të komunitetit të tyre dhe pjesëmarrja në votim janë dy dimensione të rëndësishme të masës në të cilën individët janë të integruar mirë dhe marrin pjesë në jetën shoqërore.. Rrjetet sociale janë një element tjetër i rëndësishëm i treguesit të kohezionit social, nëpërmjet të afërmve dhe mëqve, lidhjes online ose punës vullnetare. Është e vështirë të identifikohen indikatorë që lidhen drejtpërdrejtë me kohezionin dhe të krahasueshëm në përgjigje në nivel vendi në çështjet e kohezionit social. Politikat që janë relevante për dimensionet e tjera të politikës sociale (vetëjaftueshmëria, barazia dhe shëndeti) mund të ndikojnë gjithashtu në kohezionin social.

Kënaqësia e jetës përcaktohet jo vetëm nga zhvillimi ekonomik, por edhe nga përvojat e ndryshme të njerëzve dhe kushtet e jetesës.

Besimi Nnjë shoqëri kohezive është ajo ku qytetarët kanë besim tek të tjerët dhe në institucionet publike. Besimi mund të ndikojë në ecurinë ekonomike dhe politikat mund të ndikojnë në besimin dhe mirëqenien. (Algan dhe Cahuc, 2013).

Votimi në zgjedhjet parlamentare kombëtare është një tregues i pjesëmarrjes së njerëzve në jetën kombëtare të bashkësisë së tyre. Treguesi i përdorur këtu për të matur pjesëmarrjen e individëve në procesin zgjedhor është "Pjesëmarrja e

popullsisë në moshë votimi", përkatësisht përqindja e popullsisë me moshë të votuar (VAP) që aktualisht votoi - siç është e disponueshme nga të dhënat administrative të vendeve anëtare OECD-së.

Krimi dhe Burgjet. Indeksi bazohet në numrin e përgjithshëm të personave - dhe të miturve nën moshën 18 vjeçare - që kanë sjellë në kontakt formal me policinë dhe / ose sistemin e drejtësisë penale, të gjitha krimet e marra së bashku, për 100 000 banorë. Të dhënat mund të përfshijnë persona të dyshuar, ose të arrestuar ose të paralajmëruar. Çdo krahasim ndërshtetëror duhet të kryhet me kujdes për shkak të dallimeve që ekzistojnë midis përkufizimeve ligjore të veprave penale në vende ose metodave të ndryshme të numërimit dhe regjistrimit të veprave penale.

Rrjetet shoqërore përbëhen nga një grup individësh që bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, qoftë në person apo virtualisht përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Të dhënat mbi mbështetjen sociale dhe vullnetarizmin në një organizatë vijnë nga Gallup World Poll ku pyetjet e bëra për të anketuarit janë: 'Nëse gjendeni në telashe, a keni të afërm ose miq tek të cilët mund të mbështeteni për t'ju ndihmuar?' dhe 'Sa kohë pune keni shpenzuar vullnetarisht në një organizatë? A e keni bërë këtë, muajin e kaluar?'.


*Karta Sociale Evropiane e Këshillit të Evropës* përbledh një grup i integruar i standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat

sociale bashkë me një mekanizëm për monitorimin e zbatimit të tyre brenda Shteteve palë. Ky sistem që ndërton Karta:

- garanton një gamë të gjerë të të drejtave të njeriut në lidhje me nevojat bazë për punësim, kushtet e duhura të punës, strehim, arsim, kujdes shëndetsor, ndihmë mjekësore dhe mbrojtje sociale;
- vë theks të veçantë në mbrojtjen e personave më të ndjeshëm ndaj kushteve, si të moshuarit, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe migrantët. Ai kërkon që gjëzimi i të drejtave të lartpërmendura të garantohet pa diskriminim;
- ka për qëllim zbatimin në Europë të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara të vitit 1948; për këtë arsy, ajo lidhet me Sistemin e traktateve për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara dhe me Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian;
- bazohet në parimin e universalitetit, pandashmërisë, ndërvarësisë dhe ndërlidhjes së të drejtave të njeriut, siç përcaktohet në Deklaratën e Vjenës të vitit 1993 të Kombeve të Bashkuara, e cila konfirmon se të drejtat sociale janë të drejta të njeriut në mënyrë të barabartë me të drejtat civile dhe politike;
- plotëson në nivel pan-evropian masat mbrojtëse të përfshira në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila i referohet në mënyrë specifike të drejtave civile dhe politike.

- është në qendër të qëllimeve statutore të Këshillit të Evropës: të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit dhe demokracia, të cilat nuk mund të realizohen pa respektimin e të drejtave sociale.

http://www.pdf-tools.com



## **IV. Çfarë duhet të dimë për Agjensinë për Barazis Gjinore dhe përse është i rëndësishëm roli i saj?**


Agjencia për Barazi Gjinore është bërthama e mekanizmit institucional për zbatimin dhe monitorimin e Ligjit për Barazi Gjinore në Kosovë dhe tëçdo kuadri politik dhe programatik të miratuar në bazë dhe për zbatim të këtij ligji dhe kuadrit të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit në Kosovë. Kjo Agjenci është krijuar me vendim nr. 5/131 të datës 1 shkurt 2005 të Qeverisë së Kosovës, fillojmisht is Zyrë për Barazi Gjinore, si organ i veçantë brenda strukturës së Qeverisë së Kosovës në përputhje me nenin 5.1, Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2004/18, të datës 7 qershori 2004, mbi shpalljen e Ligjit për Barazi Gjinore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligi Nr. 2004/2). Me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 03/2006 të datës 12.07.06 Zyra për Barazi Gjinore, prej 1 Shtatorit 2006 shndërrohet në Agjenci për Barazi Gjinore, në Zyrën e Kryeministrat.

Agjencia për Barazi Gjinore është organ i rëndësishëm përfunksionimin e institucioneve demokratike dhe ka mandat të hartojë, të zbatojë, të propozojë, të koordinojë dhe të monitorojë politika publike vendore dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe është përgjegjëse për promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, në Kosovë.

Zyra kryesore e Agjencisë ndodhet në Prishtinë, në Ndërtesën e Qeverisë së Kosovës dhe personeli i kësaj zyre dhe të gjithë Agjencisë numëron 16 nëpunës.

Por siç përcaktohet në nenin 12 të Ligjit për Barazi Gjinore ‘Të gjitha ministritë dhe komunat janë të obliguara të caktojnë zyrtarët/et përkatës për barazi gjinore me kapacitete profesionale dhe të ndajnë burime të mjaftueshme nga buxheti, për të koordinuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji’. Ndaj puna e Agjencisëpër Barazi Gjinore, nuk mund të kuptohet dhe as të vlerësohet nëse nuk funksionon rrjeti i zyrtarëve për barazi gjinore në ministritë e qeverisë së Kosovës në komuna dhe institacione tjera publike. Ata prezantonjë Agjencinë, mandatin e saj dhe në të njëjtën kohë reflektojnë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore që në nenin 1 të tij.

Për të kuptuar më drejt rëndësinë e punës së ABGJ, nga praktikat e mira në Evropë mësojmë që në jo pak prej tyre barazia gjinore konsiderohet si një element i rëndësishëm i qeverisjes së mirë, dhe faktor përcaktues në kohezionin social të një shoqërie. Nisur nga kjo puna promovuese, koordinuese, monitoruese dhe analizuese e ABGJ-së duhet nuk duhet të ndeshë pengesa institucionale por të njohë mbështetje dhe bashkëpunim, veprim të koordinuar dhe të mirëorganizuar për arritje të objektivave strategjikë që fokusohen jo vetëm në barazinë gjinore por në ndërtimin e një shoqërie kohezive në tërësi.



## V. Cila është puna e zyrtarëve/eve për barazi gjinore në administratën publike [në nivel qendror dhe lokal ]?

Zyrtarët/et për barazi gjinore janë shërbyes civilë të administratës publike të Kosovës në nivel qendror [ministritë] dhe në nivel qendror [komunat]. Ata nuk janë personel i punësuar nga Agjencia për e Barazi Gjinore, por puna e tyre, pra detyrat dhe funksionet rregullohen nga Ligji për Barazi Gjinore, zbatimi i të cilit monitorohet nga ABGJ. Zyrtarët për Barazi Gjinore rekrutohen në Shërbimin Civil të Kosovës në bazë të standarteve, procedurave dhe kriterieve të përcaktuara në Ligjin për Shërbimin Civil dhe rregullorja per pershkrimin e detyrave dhe perjegjësive të ZBGJ NR 02/2016. Zyrtarët/et përkatës për barazi gjinore detyrat dhe perjegjësitë e tyre i ushtrojnë në pajtim me dispozitat e përcaktuara me këtë ligj dhe me aktin përkatës nënligjor që miratohet nga qeveria, sipas propozimit nga AgjenciaNR 02/2016. Ato obligohen që prioritetet e parapara në këtë program t'i planifikojnë, integrojnë dhe prezantojnë në dokumentë strategjike të ministrive perkatese dhe në komunat ku punojnë. Përfshirja e perspektivës gjinore ne dokumentet strategjike të punës së çdo institucioni qoftë në nivel qendror [ministritë] ashtu edhe në nivel lokal[komunat] përbën thelbin dhe synimin kryesor të punës së zyrtarëve/eve të barazisë gjinore në institacione. Kjo mund të realizohet përmes organizmit të trajnimeve dhe ngjarjeve/fushatave sensibilizuese, rishikimit të akteve te ndryshme administrative dhe ligjore, monitorimit të buxhetit etj. Rol i tyre duhet jetë aktiv për

përfshirjen e perspektivës gjinore në mobilizimin e burimeve dhe të njerëzve drejt objektivave strategjikë të institucionit.

Në praktikë, zyrtarët për barazi gjinore nuk mund dhe nuk duhet të presin të ndodhë diskriminimi në administratën ku punojnë, që më pas ata të ndërmarrin një veprim. Përkundrazi, prej tyre kërkohet që të kenë një rol sa më aktiv dhe të jenë nxitës dhe zbatues me veprime konkrete të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe ligjit përkatës në tërësi, në sektorin ose territorin ku ata punojnë.

http://www.pdf-tools.com



## VI. Çfarë është Programi i Kosovës për Barazi Gjinore?

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ) është një dokument pune, por që njëkohësisht konfirmon angazhimin dhe vullnetin politik të Qeverisë së Kosovës për të punuar në arritjen dhe respektimin e standardeve dhe praktikave më të mira evropiane dhe ndërkombëtare të barazisë gjinore. Ai synon të krijojë një mjedis të përshtatshëm dhe specifik për ndryshime në kushtet e jetesës së grave dhe vajzave në Kosovë, si dhe për eliminimin e ndasive të cilat janë të lidhura ngushtë me varfërinë, pasi që Kosova është një shtet i ri me një demokraci ende të re.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore është në fakt dokumenti kryesor i punës së Agjencisë së Barazisë Gjinore. "Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore" ofron një vizion të përmirësuar afatmesëm për arritjen e barazisë gjinore. Dokumenti bazohet në orientimet strategjike të vendosura në Strategjinë e Planit Zhvillimor të Kosovës, duke iu përgjigjur qëllimeve të Integrimit Evropian si dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

PKBGJ ka për qëllim të nxisë dialogun mbi integrimin e barazisë gjinore në Kosovë, që do të thotë pjesëmarje e barabartë e grave dhe burrave ne jetën sociale, ekonomike e politike te vendit, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në dobi te shoqërisë. Objektivat e këtij dokumenti janë; (a) të analizojë gjendjen aktuale të grave dhe burrave ne Kosove duke dhëne ecurinë afatshkurtër dhe afatmesme të fenomeneve dhe ndikimin e tyre ne luftën kundër

varfërisë; (b) të identifikojë mundësitë duke përfshire politikat dhe institucionet në shërbim të barazisë gjinore; (c) të identifikoje fushat për ndërhyrje dhe te rekomandojë politikat, programet dhe masat për zgjidhjen e problemeve dhe përballimin e sfidave që paraqet lufta kundër varfërisë dhe zhvillimi ekonomik e social i vendit; (d) te hartojë sa të jetë e mundur një buxhet i cili do te jetë një mekanizëm në duart e qeverise së Kosovës për arritjen e objektivave. Është mjaft e lehtë për të kuptuar natyrën ndërsektoriale të programit.

Nisur nga kjo dhe harta institucionale e zbatimit të programit në nivel qendror dhe vendor, vlera e shtuar e tij qëndron në ndihmën që ky program i ofron institucioneve të Qeverisë së Kosovës në drejtim të:

- Adresimit të çështjeve të barazisë gjinore (istorike, ekonomike, sociale, kulturore, e politike).
- Aftësimit të kapaciteteve për një vendimmarrje gjithëpërfshirëse.
- Shpërndarjes rationale dhe të drejtpeshuar të burimeve njerëzore, materiale e financiare.
- Hartimit të planit të veprimit për integrim të barazisë gjinore në sektorin/territorin ku ato punojnë.



## VII. Përse stastistikat zyrtare i referohen seksit dhe jo gjinisë? Ku është dallimi?

Të dhënat e ndara sipas seksit mund të përcaktohen si të dhëna që mblidhen dhe paraqiten më vete për gratë dhe më vete për burrat. Ato janë informacione statistikore sasiore mbi dallimet dhe pabarazitë midis grave dhe burrave. Ka një paqartësi të madhe dhe keqpërdorim të termave “të dhëna të ndara sipas gjinisë” dhe “të dhëna të ndara sipas seksit”. Të dhënat duhet të jenë pa tjetër të ndara sipas seksit, por jo të ndara sipas gjinisë, meqenëse femrat dhe meshkujt numërohen sipas dallimeve të tyre biologjike dhe jo sipas sjelljeve të tyre shoqërore. Termi të dhëna të ndara sipas gjinisë përdoret shpesh, por duhet të kuptohet se i referohet të dhënavë të ndara sipas seksit. Dallimet në përkufizimin ‘të dhëna të ndara sipas gjinisë/seksit’ e janë sqaruar në detaje në seksionin 10 ‘Koncepte dhe përkufizime të nevojshme’

Të dhënat statistikore të qarta, të besueshme dhe në kohën e duhur, për të gjithë sektorët tradicionalëtëstatistikave, si arsimi, shëndetësia dhe punësimi, por edhe në çështje të reja si ndryshimet klimatike, kanë rëndësi themelore për të kuptuar dallimet midis grave dhe burrave në një shoqëri të caktuar. Informacione të tillë janë jetësore për politikat dhe vendim-marrësit, si dhe për të përparuar drejt barazisëgjinore. Për të siguruar që angazhimet për barazinë gjinore të shoqërohen me planifikim dhe buxhetim më tëmirë dhe të përkthehen në rezultate të prekshme, nevojitet një qasje me orientim të qartë nga rezultatet, që nxit vendimmarrje të mbështetur mbi prova. Kjo kërkon

investim dhe përdorim të provave dhe analizave sistematike me cilësi të lartë, për të hartuar qasjet e duhura që i përgjigjen pabarazive ndërmjet grave dhe burrave në proceset sociale, politike dhe demografike të një vendi. Për këtëqëllim mbledhja, analiza dhe përdorimi i të dhënave të besueshme, të krahasueshme dhe koherente, tëndara sipas moshës dhe seksit, është parakusht i domosdoshëm. Zhvillimi i analizave statistikore për gjinitë dhe barazinë mes tyre, përfshin hapa të njëjtë si në rastet e statistikave të tjera, por me një qasje specifike për integrim të çështjeve gjinore dhe reflektim të shqetësimeve që ekzistojnë në lidhje me barazinë gjinore.

Në këtë hapat kryesorë që duhet të ndërmerrin për një analizë sa më të saktë, përfshijnë:

- a. zgjedhjen e temave që do të hulumtohen;
- b. identifikimin e statistikave që do të mblidhen dhe që pasqyrojnë çështjet gjinore në shoqëri;
- c. formulimin e koncepteve dhe përkufizimeve që pasqyrojnë në mënyrë të duhur dallimet ndërmjet grave dhe burrave në shoqëri;
- d. zhvillimin e metodave të mbledhjes së të dhënave që marrin në konsideratë stereotipet dhe faktorët socialë dhe kulturorë që mund të prodhojnë paqartësi dhe paragjykime mbi gjininë.
- e. Zhvillimin e analizave dhe të publikimeve të dhënave që mbërrijnë tryezat e hartuesve të politikave dhe audiencën vendore më të madhe të mundshme.



## VIII. Instrumente ligjore kryesore që rregullojnë barazinë gjinore në Kosovë

<i>Titulli i instrumentit dhe data e publikimit</i>	<b>KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 09.04.2008</b>
<i>Qëllimi</i>	Bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkontëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. (Neni 3.2.)
<i>Të drejtat tematike të garantuara</i>	Republika e Kosovës siguron BARAZINË GJINORE si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore. (Neni 7.2.)  Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gjëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim (Neni 24) Përbërja e Kuvendit të Kosovës respekton parimet e barazisë gjinore të cilat janë të pranuara në pajtim me parimet ndërkontëtarisht. (Neni 71.2.)  Përbërja e shërbimit civil pasqyron shumëlojshmërinë e popullsisë së Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e BARAZISË GJINORE, të njohura ndërkontëtarisht (Neni 101.1.)
<i>Institucionet e përfshira</i>	Qeveria e Kosovës, Kuvendi i Kosovës,
<i>drejtpërdrejt</i>	Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës, Komunat e Kosovës

<i>Metoda e zbatimit</i>	E drejtpërdrejtë
<i>Efekti i përfthuar</i>	I drejtpërdrejt
<i>Niveli i legjislacionit</i>	Vendor [I brendshëm]
<i>Burimi i informacionit dhe gjuha</i>	<u>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</u> Shqip, English, Srpski, Türkçe, Bosanski

<b>Titulli i instrumentit dhe data e publikimit</b>	<b>LIGJI PËR BARAZI GJINORE 05/L-020, 26.06.2015</b>
<b>Qëllimi</b>	Ky ligj, garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.
<b>Të drejtat tematike të garantuara</b>	Me zbatimin e masave ligjore dhe affirmative vendoset pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në organet e të gjitha nivelevë të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet publike, në mënyrë që pjesëmarrja në këto institucionë të arrije nivelin e pjesëmarjes së tyre te popullata e përgjithshme e Kosovës. Pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve arrihet në rastet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucionë, organe apo në nivele të pushtetit është 50 %. Sektori publik, privat si dhe institucionet ligjvënëse dhe ekzekutive në sektorin e punës dhe të punësimit, sigurojnë të drejta dhe mundësi të barabarta përfmaja e femrave dhe meshkujve. Puna e papaguar e femrave dhe meshkujve vlerësohet kontribut në zhvillimin e familjes dhe shoqërisë në raste

	<p>të: a) kujdesit për mirëqenien familjare; b) kujdesit për fëmijët; c) kujdesit për anëtarë të tjerë të familjes; d) punës në bujqësi dhe ekonomi familjare,etj;</p> <p>Në të gjitha nivelet e arsimit dhe edukimit duhet të mundësohet arsimimi dhe edukimi i barabartë i femrave dhe meshkujve për pjesëmarrje e tyre aktive në shoqëri, në jetën familjare dhe në tregun e punës.Pasuria e krijuar gjatë jetës në martesë regjistrohet në regjistrat publik, si pronë e përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve.</p>
Institucionet e përfshira drejtpërdrejt	Agjencia për Barazi Gjinore, Qeveria e Kosovës, Kuvendi, Ombudsperson, Komunat, Policia, Gjykatat themelore, Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme, Media.
Metoda e zbatimit	E drejtpërdrejtë
Efekti i përfthuar	I drejtpërdrejt
Niveli i legjisacionit	Vendor [I brendshëm]
Burimi i informacionit dhe gjuha	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Shqip, English, Srpski

<i>Titulli i instrumentit dhe data e publikimit</i>	<b>LIGJI KUNDËR DISKRIMINIMIT 05/L-021 – 26.06.2015</b>
<i>Qëllimi</i>	Ndalon të gjitha format e diskriminimit në shoqëri, përfshirë këtu diskriminimin në baza gjinore. Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, ngritura e shkallës së barazisë efektive dhe realizimi I parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës para Ligji (Neni 1.)

<i>Të drejtat tematike të garantuara</i>	Ndalohet diskriminimi nëçfarëdo forme, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statuseve tjera; (Neni 2.a).
<i>Institucionet e përfshira drejtpërdrejt</i>	Avokati i popullit në Kosovë [Ombudsperson], Gjykatat themelore, Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme, Gjykata Kushtetuese
<i>Metoda e zbatimit</i>	E drejtpërdrejtë
<i>Efekti i përfthuar</i>	I drejtpërdrejt
<i>Niveli i legjislacionit</i>	Vendor [I brendshëm]
<i>Burimi i informacionit dhe gjuha</i>	<u>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</u> Shqip, English, Srpski

<i>Titulli i instrumentit dhe data e publikimit</i>	<b>LIGJI NR. 2004/26 PËR TRASHËGIMINË I KOSOVËS</b>
<i>Qëllimi</i>	Femrat dhe meshkujt kanë të drejta të barabarta në trashëgimi. Të gjithë personat fizikë në kushte të njëjtë janë të barabartë në trashëgimi. (Neni 3.1.)

<i>Të drejtat tematike të garantuara</i>	Fëmijët e lindur jashtëmartese, kur atësia është njohur rregullisht ose është vërtetuar me vendim të gjykatës apo të organit kompetent si dhe fëmijët e adoptuar barazohen me fëmijët legjitim. (Neni 3.2.) Trashëgimtarë ligjorë janë: fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllëzërit e motrat dhe pasardhësite tyre,
	gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre. (Neni 11.1.) Me ligj ttrashëgimlënësin e trashëgon dhe bashkëshorti i tij jashtë-martesor, i cili barazohet me bashkëshortin martesor. Bashkësi jashtëmartesore nëkuptim të këtij ligji konsiderohet bashkësia jetësore e gruas së pamartuar dhe e burrit të pamartuar e cila ka zgjatur njëkohëtëgjatë dhe që ka pushuar me vdekjen e trashëgimlënësit, mekusht të kenë qenë plotësuar prezumimet përvlefshmérinë e martesës. (Neni 11.2.) Bashkëshorti i trashëgimlënësit ka të drejtë të kërkojë pjesën që i takon nëpasurinë e përbashkët të fituar me punë nga bashkëshortët gjatë martesës. (Neni 26.1.) Në se trashëgimlënësi dhe bashkëshorti i tij kanë pasur pasuri të përbashkët sipas regjimit të tyret të pasurisë bashkëshortore, vetëm pjesa që i takon trashëgimlënësit pas ndarjes së pasurisë së përbashkët bëhet objekt i trashëgimisë. (Neni 26.2.)

<i>Institucionet e përfshira drejtpërdrejt</i>	Avokati i popullit në Kosovë [Ombudsperson], Agjencia Kadastrale e Kosovës, Gjykatat themelore, Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme, Gjykata Kushtetuese
<i>Metoda e zbatimit</i>	E drejtpërdrejtë
<i>Efekti i përfthuar</i>	I drejtpërdrejt
<i>Niveli i legjislacionit</i>	Vendor [I brendshëm]
<i>Burimi i informacionit dhe gjuha</i>	<u>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</u> Shqip, English, Srpski

<b>Titulli i instrumentit dhe data e publikimit</b>	<b>LIGJI PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE 03/L-182, Datë 10.08.2010</b>
<b>Qëllimi</b>	Ky ligj ka përqëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktima të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. (Neni 1.)

Të drejtat tematike të garantuara	Gjykata vendos përkitazi me kërkesën për urdhër mbrojtje emergjente brenda njëzet e katër (24) orëve pas parashtrimit të kërkesës. Me rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtje emergjente, gjykata duhet të mbajë seancë në të cilën dëgjohen personat në vijim: a) pala e mbrojtur, përfaqësuesi i autorizuar, ose mbrojtësi i viktimate; b) kryerësi i dhunës ose përfaqësuesi i autorizuar; c) parashtruesi i kërkesës; dhe d) çdo dëshmitar, i cili ka njojuri për dhunën në familje.  Sipas nevojës, gjykata mund të bëjë dëgjimin dhe shqiptimin e urdhrit mbrojtës në mungesë të kryerësit të dhunës ne familje, duke shfrytëzuar dhe mjetet tjera alternative përfshire ato elektronike.
Institucionet e përfshira drejtpërdrejt	Policia, Gjykatat themelore, Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Metoda e zbatimit	E drejtpërdrejtë
Efekti i përfshiruar	I drejtpërdrejt
Niveli i legjisacionit	Vendor [I brendshëm]
Burimi i informacionit dhe gjuha	<u>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</u> Shqip, English, Srpski

Titulli i instrumentit dhe data e publikimit	<b>KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS 13.07.2012</b>
--	--

Qëllimi	<p>Vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm (Neni 7).</p>
Të drejtat tematike të garantuara	<p>Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrrethanat e mëposhtme rënduese: nëse vepra penale kryhet ndaj personit ose grupit të personave, ose pronës, për shkak të origjinës etnike ose kombëtare, shtetësisë, gjuhës, besimeve fetare, ose mungesës së besimeve fetare, ngjyrës, gjinisë, orientimeve seksuale, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura (Neni 74.2.12). Për qëllime të këtij nenit: Shprehja "gjini" i referohet të dy gjinive, mashkullit dhe fémrës, brenda kontekstit të shoqërisë (Neni 149.2.10). Kushdo që e asgjëson, dëmton apo e bën të papërdorshme pasurinë e personit tjetër në rrrethana te tjera nga ato të përcaktuara në nenin 334 të këtij Kodi, dënohet me burgim deri në një (1) vit (Neni 333.1).</p>

	<p>Kur vepra penale nga paragrafi 1.i këtij neni është kryer për shkak të paragjykimeve ndaj kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njëren nga këto karakteristika të mbrojtura, kryesi i veprës penale dënohet me burgim deri në tre (3) vjet (Neni 333.4).</p> <p>Kushdo që në kundërshtim me ligjin për ndërprerjen e shtatzënësë dhe me pëlqimin e gruas shtatzënë, ndërpres shtatzënë, fillon ta kryej ndërprerjen e shtatzënësë ose i ndihmon që ta ndërpres shtatzënë, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet (Neni 184.1).</p> <p>Kushdo që e ndërprenë ose fillon ta ndërpresë shtatzënë pa pëlqimin e gruas shtatzënë, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet (Neni 184.2).</p> <p>Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor, me dëmtim të rëndë të shëndetit ose me vdekje të gruas shtatzënë, kryesi dënohet me: 3.1.burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni; ose 3.2.burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet për veprën penale nga paragrafi 2. i këtij neni (Neni 184.3).</p>
Institucionet e përfshira drejtpërdrejt	Avokati i popullit në Kosovë [Ombudsperson], Agjencia Kadastrale e Kosovës, Gjykatat themelore, Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme, Gjykata

	Kushtetuese
Metoda e zbatimit	E drejtpërdrejtë
Efekti i përfthuar	I drejtpërdrejt
Niveli i legjislacionit	Vendor [I brendshëm]
Burimi i informacionit dhe gjuha	<u>Gazeta Zyrtare nr.19/2012</u> Shqip, English, Srpski

Titulli i instrumentit dhe data e publikimit	<b>LIGJI PËR FAMILJEN 01.09.2006</b>
Qëllimi	Ky ligj, garanton, mbrojnë dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.

Të drejtat tematike të garantuara	<p>Të gjithë anëtarët e familjes janë të barabartë dhe duhet të trajtohen sitë e tillë. Parimi I barazisë ndërmjet burrit dhe gruas, respektit dhe ndihmës së ndërjellët ndërmjet tyre dhe anëtarëve të familjes. (Neni 3.1.)</p> <p>Për realizimin e të drejtave nga marrëdhëniet familjare, nënës dhe fëmijës u sigurohet mbrojtje e posaçme me mjete të mirëqenies sociale. (Neni 7.1.)</p> <p>Mashkulli dhe femra kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, kombësisë apo religionit, si dhe janë të BARABARTË gjatë lidhjes së martesës dhe zgjidhjes së saj. (Neni 14.1.2)</p> <p>Bashkëshortët në martesë janë të barabartë, në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pronësore. (Neni 42.1.)</p> <p>Bashkëshortët vendosin për udhëheqjen e ekonomisë së përbashkët familjare me</p>
-----------------------------------	--

http://www.

	<p>marrëveshje. (Neni 44.2.)</p> <p>Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse ndryshe nuk janë marrë vesh. (Neni 47.4.)</p> <p>Pasurinë e fituar përmes punës së përbashkët të burrit dhe të gruas në marrëdhëniet jashtëmartesore konsiderohet pasuri e tyre e përbashkët. Pasuria e fituar gjatë bashkësisë jashtëmartesore dhe e cila pasuri i nënshtrohet ndarjes ose pjesëtimit konsiderohet pasuri e përbashkët. Dispozitat e këtij ligji lidhur me ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve të një marteseligjërisht të regjistruar zbatohen në mënyrë analoge përmarrëdhëniet pronësore të personave në bashkësi jashtëmartesore. (Neni 58.1.2.)</p> <p>Përgjegjësia prindërore përfshinë të drejtat dhe detyrat që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materjale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë. (Neni 128.4)</p>
Institucionet përfshira drejtpërdrejt	e Komunat, Organi i Kujdestarisë, Agjencia për Barazi Gjinore, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ombudsperson, Policia, Gjykatat themelore, Gjykata e Apelit, Gjykata

	Supreme, Media.
Metoda e zbatimit	E drejtpërdrejtë
Efekti i përfthuar	I drejtpërdrejt
Niveli i legjislacionit	Vendor [I brendshëm]
Burimi i informacionit dhe gjuha	<u>Gazeta Zyrtare nr. 04/2006</u> Shqip, English, Srpski

Titulli i instrumentit dhe data e publikimit	<b>LIGJI I PUNËS [NR. 03/L-212 I] 01.12.2010</b>
Qëllimi	Ky ligj ka për qëllim të rregullojë të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, siç përcaktohen me këtë ligj.

Të drejtat tematike të garantuara	<p>Punëdhënësit duhet të krijojë kushte të barabarta për të dy gjinitë. Çdo dallim që përfshin përjashtim ose dhënie të përparësisë në bazë të racës, ngjyrës, GJINISË, fesë, moshës, gjendjes familjare, mendimit politikë, prejardhjes kombëtare ose sociale, gjuhës ose anëtarësisë sindikale, që e ka fuqinë e anulimit ose mosdhënies së mundësive të barabarta për punësim apo profesion apo ngritje profesionale. (Neni 1.17)</p> <p>Punëdhënësi është i obliguar që në rastin e punësimit të punëtorëve, për të njëjtin vend pune të përcaktojë kriteret dhe mundësi të barabarta si për femra ashtu edhe për meshkuj. (Neni 5.4.5)</p> <p>Konkursi publik duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë</p>
-----------------------------------	--

lloj diskriminimi. (Neni 8.2)

Punëdhënësi nuk mund të bëjë zgjatjen e orarit të punës për të punësuarën gjatë kohës së shtatzënësë dhe prindin vetushqyes me fëmijë më të ri se 3 vjeç, ose me fëmijë të me nevoja të veçanta. (Neni 26.2)

Ndalohet puna e natës për personat nën moshën 18 vjeç dhe të punësuarat shtatzëna dhe gratë gjidhënëse. Ndërrimet e natës mund të kryhen nga prindërit e vetëm dhe grata me fëmijë më të rinj se 3 vjeç, ose me fëmijë me aftësi të kufizuara të përherershme, vetëm me pëlqimin e tyre. (Neni 27.3) Nënat me fëmijë deri në 3 vjeç si dhe prindi vetushqyes dhe personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë në pushim vjetor edhe për 2 ditë pune shtesë. (Neni 32.4).

Femrës shtatzënë dhe gjidhënëse i ndalohet të bëjë punë e cila është e përcaktuar si e dëmshme për shëndetin e nënës apo të fëmijës. (Neni 46)

Pushimi i lehonisë: Femra e punësuar gëzon të drejtën prej 12 muajve, të pushimit të lehonisë. (Neni 49).

Me prezentimin e çertifikatës mjekësore, femra e punësuar mund ta fillojë pushimin e lehonisë deri në 45 ditë para datës kur pritet të lindë. Në periudhën prej 28 ditëve para datës kur pritet të lindë, punëdhënësi me pëlqimin e femrës shtatzënë, mund të kërkojë që ajo ta fillojë pushimin e lehonisë, nëse punëdhënësi mendon se femra e punësuar nuk është në gjendje t'i kryejë

detyrat e saj.

- 6 muajt e parë të pushimit të lehonisë, pagesa bëhet nga punëdhënësi me kompenzim 70% të pagës bazë. 3 muajt në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë.

- Femra e punësuar ka të drejtë me këtë ligj që ta zgjasë pushimin e saj të lehonisë edhe për 3 muaj të tjera pa pagesë.

- Babai i fëmijës mund të marrë të drejtat e nënës, nëse nëna vdes ose e braktis fëmijën para se të përfundojë pushimi i lehonisë.

- Të drejtat nga paragrafi 4. dhe 5. i këtij nenii mund të barten te babai I fëmijës në marrëveshje me nënën.

Të drejtat e përcaktuara sipas nenit 49 të këtij ligjimund t'i realizojë edhe i ati i fëmijës me rastin e sëmundjes së nënës, braktisjes së fëmijës nga nëna dhe vdekjes së nënës.

Babai i fëmijës ka të drejtën për: 2 ditë pushim me pagesë me rastin e lindjes së fëmijës ose adoptimit të fëmijës; 2 javë pushim të papaguar pas lindjes së fëmijës, ose adoptimit të fëmijës, në periudhën derisa fëmija ta ketë arritur moshën 3 vjeç. I punësuari duhet të informojë punëdhënësin për qëllimet e tij për ta marrë pushimin, së paku 10 ditë më herët. (Neni 50)

Pushimi I lehonisë për humbjen e fëmijës - Nëse femra e punësuar lind fëmijë të vdekur, ose nëse fëmija i vdes para skadimit të pushimit të lehonisë, ka të drejtë për

	<p>pushim lehonie sipas konstatimit të mjekut, për sa kohë i nevoitet të këndellet nga lindja dhe nga gjendja psikike e shkaktuar nga humbja e fëmijës, por jo më pak 45 ditë, dhe për këtë kohë i takojnë të gjitha të drejtat mbi bazën e pushimit të lehonisë. (Neni 51) Ndalimi i shkëputjes së kontratës – Gjatë kohës së shtatzënisi, pushimit të lehonisë dhe mungesës në punë për shkak të përkujdesjes së veçantë ndaj fëmijës, punëdhënësi nuk mund t'ia shkëpusë kontratën të punësuarit dhe t'ia ndërrojë vendin e punës, përvèç në rastet e shkëputjes së kontratës sipas nenit 76 të këtij ligji (Largimet kolektive nga puna). (Neni 53.1) Punëdhënësiduhet t'i paguaj femrave dhe meshkujve kompenzimin e njejtë për punën e vlerës së njejtë, kompenzim I cili mbulon pagën bazë dhe shtesat e tjera. (Neni 55.3)</p>
Institucionet e përfshira drejtpërdrejt	Ministria - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS); IP - Inspektorati i Punës; QRP -Qendra Rajonale e Punësimit; ZP - Zyrat e Punësimit.
Metoda e zbatimit	E drejtpërdrejtë
Efekti i përfshuar	I drejtpërdrejt
Niveli i legjisacionit	Vendor [I brendshëm]
Burimi i informacionit dhe gjuha	<u>Gazeta Zyrtare nr.90/2010</u> Shqip, English, Srpski

Titulli i instrumentit

**LIGJI PËR ARSIMIN**

dhe data e publikimit	<b>PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS [NR. 04/L-032]31.08.2011</b>
Qëllimi	Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele.

Të drejtat tematike të garantuara

1. Asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta për arsimim (Neni 3.1).

Qasja dhe përparimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimit parauniversitar do të mundësohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji pa diskriminim në baza ekzistuese ose të supozuara, siç është ai: gjinor, racion, i orientimit seksual, i paaftësitet fizike, intelektuale ose i çfarëdo paaftësie tjeter, i gjendjes martesore, i ngjyrës, i fesë, i opinioneve politike apo të tjera, i përkatësisëkombëtare, etnike ose shoqërore, i shoqërimit me ndonjëkomunitet, i pronës, i lindjes ose i ndonjë gjendje tjeter të nxënësit apo familjes së tij (Neni 2.6).

Ndalohen aktivitetet promovuese jashtë Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës në përfitim ose në dëm të çfarëdo partie politike, gjinie, përkatësie racore a etnike, feje ose pozite sociale nëpër institucionet arsimore dhe aftësuese. Kur çështjet relevante paraqiten para nxënësve gjatë procesit mësimor, nxënësve duhet t'u ofrohet prezantim i balancuar i pikëpamjeve të kundërta (Neni 4.3).

Ministria mban përgjegjësinë kryesore për

planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar, si dhe ka detyrat e përgjithshme që:të promovojë sistem jo diskriminues, të arsimit në të cilin respektohen të drejtat e seclitperson për arsim dhe aftësim, si dhe ofrohen mundësi të barabarta për arsim cilësor (Neni 5.1.3).

Mësimdhënësit janë të mbrojtur nga diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë për arsyen reale apo të supozuara siç janë gjinia, raca, gjendja martesore, orientimi seksual, ngjyra, feja, pikëpamjet politike apo të tjera; prejardhja kombëtare, etnike apo sociale, përkatësia ndaj një komuniteti etnik, nevojat e veçanta, pronësia, lindja apo rrethana të tjera (Neni 36.3.2).

Qëllimi i qartë i këtij Ligji është që parimi i arsimit gjithëpërfshirës të zbatohet në Republikën e Kosovës si praktika më e mirë në përputhje me normat ndërkombëtare, si parashihen në Konventën e UNESCO-s për të Drejtat e Fëmijëve (1989), në Deklaratën e Salamankës (1994), Konventën e OKB-së për të Drejta të Personave me Aftësi të Kufizuar (2007) dhe në konventat apo rekomandimet e tjerapërkatëse ndërkombëtare (Neni 40.1).

Parimi i arsimit gjithëpërfshirës nënkuption se: institucionet arsimore dhe aftësuese duhet të akomodojnë të gjithë fëmijët, pa dallim të kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera dhe duhet të promovojë integrimin dhe

http://www.mnf.gov.kro

	kontaktin mes fëmijëve (Neni 40.2.1).
Institucionet e përfshira drejtpërdrejt	Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), Agjencia e Kosovës për Kurrikulum, Standarde dhe Vlerësim (AKKSV), Ministria e Arsimit, e Shkencës, dhe e Teknologjisë, Drejtori Komunal i Arsimit (DKA), Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK).
Metoda e zbatimit	E drejtpërdrejtë
Efekti i përfthuar	I drejtpërdrejt
Niveli i legjisacionit	Vendor [I brendshëm]
Burimi i informacionit dhe gjuha	<u>Gazeta Zyrtare nr.17/2011</u> Shqip, English, Srpski

Titulli i instrumentit dhe data e publikimit	<b>LIGJI PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKEN E KOSOVËS [NR. 04/L- 037] 31.08.2011</b>
Qëllimi	Qëllimi i Ligjit të arsimit të lartë është krijimi i bazës ligjore për rregullimin, funksionimin, financimin, sigurimin e cilësisë ne arsimin e lartë ne përputhje me standarde evropiane si dhe rolin e shtetit dheshoqërisë ne zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

Të drejtat tematike të garantuara	Partneriteti publiko-privat mund të themelohet për të ofruar shërbime të arsimit të lartë. Formimi i tij do të jetë në përputhje me parimet e barazisë së trajtimit, mosdiskriminimit, transparencës, përpjesëtimit, efektshmërisë së kostos, eficiencës, mbrojtjes së interesit publik, lirisë së konkurrencës dhe të vlerës së fituar për para si dhe do të jetë në përputhje
-----------------------------------	---

me Ligjin për partneritetet publiko-privat dhe koncesionet në infrastrukturë si dhe me procedurat përdhënien e tyre (Ligji -03/L-090, qershor 2009). (Neni 3.15)

Ofrimi i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës bazohej në parimet si në vijim: mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit télartë pa diskriminim (Neni 2.1.3).

Në arsimin e lartë që ofrohet nga bartësit e licencuar të arsimit të lartë në Kosovë do të kenë qasjetë gjithë personat brenda apo jashtë territorit të Kosovës, pa asnjë lloj diskriminimi (Neni 5.1).

Ministria nuk caktor asnjë kusht që do të mund të ndikonte në kufizimin e mundësisë së bartësit përtë vepruar, në përputhje me statutin e tij, për të térhequr fonde nga burime të tjera, përfshirë këtuçaktimin e vendeve shtesë të studimit brenda kufijve të licencës, me kusht që, sipas mendimit të Ministrisë, kjo nuk paragjykon detyrën e bartësit për të ushtruar veprimtarinë e tij pa asnjë llojdiskriminimi për arsy që kanë lidhje me gjininë, racën, prirjen seksuale, aftësinë e kufizuar, gjendjen martesore, ngjyrën, gjuhën, fenë, opinionet politike apo të tjera, origjinën kombëtare, etnike apo sociale, përkatesinë ndaj një komuniteti etnik, pronësinë, lindjen apo që lidhen me gjendje të tjera (Neni 22.3.2). Statuti i çdo bartësi të arsimit të lartë dhe struktura e çdo bartësi privat të arsimit të lartë, si kusht përkreditim, duhet të përmbajnë dispozita që: mbrojnë personelin

	nga çdo lloj diskriminimi (Neni 27.4.2). Statuti ose dokumenti themelues i barasvlershëm me të i çdo bartësi të arsimit të lartë përmban dispozita, të cilat: mbrojnë studentët nga çdo lloj diskriminimi (Neni 31.4.3).
Institucionet e përfshira drejtpërdrejt	Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), Agjencia e Kosovës për Kurrikulum, Standarde dhe Vlerësim (AKKSV), Ministria e Arsimit, e Shkencës, dhe e Teknologjisë, Drejtor Komunal i Arsimit (DKA), Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK).
Metoda e zbatimit	E drejtpërdrejtë
Efekti i përfthuar	I drejtpërdrejt
Niveli i legjislacionit	Vendor [I brendshëm]
Burimi i informacionit dhe gujuha	<u>Gazeta Zyrtare nr.14/2011</u> Shqip, English, Srpski

Titulli i instrumentit dhe data e publikimit	<b>LIGJI PËR BOTIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE, MJETEVE MËSIMORE, LEKTYRËS SHKOLLORE DHE TË DOKUMENTACIONIT PEDAGOGJIK NR. 02/L-67 29.06.2006</b>
Qëllimi	Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të MASHT-it, të autorit dhe të botuesit. Neni 2.3

Të drejtat tematike të garantuara	Nuk lejohen tekstet shkollore, mjetet mësimore, lektyrat shkollore dhe dokumentacioni pedagogjik që bëjnë propagandë kundër Kosovës, që cenojnë të drejtat e
	njeriut dhe barazinë gjinore dhe që nxisin urrejtje politike, nacionale dhe fetare. Neni 3.2
Institucionet e përfshira drejtpërdrejt	Ministria e Arsimit, e Shkencës, dhe e Teknologjisë
Metoda e zbatimit	E drejtpërdrejtë
Efekti i përfthuar	I drejtpërdrejt
Niveli i legjislacionit	Vendor [I brendshëm]
Burimi i informacionit dhe gjuha	<u>Gazeta Zyrtare nr. 09/2007</u> Shqip, English, Srpski

Titulli i instrumentit dhe data e publikimit	<b>LIGJI NR. 03/L-149 PËR SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b> <b>14.06.2010</b>
Qëllimi	Ky ligj rregullon statusin e nëpunësve civilë, si dhe marrëdhënien e tyre të punës në institucionet e administratës qendrore dhe komunale. Neni 1.1

Të drejtat tematike të garantuara	Jodiskriminimi - Nuk lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. Neni 5.1.2 Parimi i mundësive të barabarta për komunitete dhe gjini - Komunitetet dhe
-----------------------------------	---

pjesëtarët e tyre kanë mundësi të barabarta për pjesëmarrje në shërbimin civil në institucionet e administratës qendrore dhe komunale. Mundësi të barabarta për pjesëmarrje në shërbimin civil në organet e administratës publike kanë pjesëtarët e dy gjinive. Neni 5.1.9

Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve. Neni 11.1

Qasja, përmes gradimit, në nivele më të larta të hierarkisë funksionale në Shërbimin Civil të Kosovës bazohet ekskluzivisht në meritë, aftësi dhe përvojë, dhe është e hapur për të gjithë nëpunësit civilëtëkualifikuar përmes konkurrencës, pa cenuar parimet e mosdiskriminimit të përcaktuara me këtë ligj dheme Ligjin Kundër

Diskriminimit. Neni 26.2

Nëpunësit civilë kanë të drejtë në trajtim të barabartë në të gjitha aspektet e menaxhimit të personelit, duke përfshirë karrierën, shpërblimet, kompensimin dhe mbrojtjen ligjore, pavarësisht nga gjinia,raca,besimi fetar, politik, aftësitë e kufizuara, kushtet, statusi martesor, mosha ose prejardhja etnike. Neni 43.1


Institucionet e përfshira drejtpërdrejt	Instituti i Kosovës për Administratë Publike, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil , Ministria për Administratë Publike, Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil, Ombudsperson
Metoda e zbatimit	E drejtpërdrejtë
Efekti i përfthuar	I drejtpërdrejt
Niveli i legjisacionit	Vendor [I brendshëm]
Burimi i informacionit dhe gjuha	<u>Gazeta Zyrtare nr. 72/2010</u> Shqip, English, Srpski

Titulli i instrumentit dhe data e publikimit	<b>LIGJI PËR SHËNDETËSI Nr. 04/L-125 26.04.2013</b>
Qëllimi	Ky ligj ka përqëllim sigurimin e bazës ligjore për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese, dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor. Neni 1.

Të drejtat tematike të garantuara	Kujdesi shëndetësor zbatohet duke u udhëhequr nga parimet themelore, si vijon: gjithë-përfshirja dhe jo diskriminimi: standarde të barabarta në kujdesin shëndetësor përtë gjithë qytetarët dhe banorët duke siguruar standardet gjatë përbushjes së kërkesave në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, si dhe sigurim i kujdesit shëndetësor pa diskriminim në bazë të gjinisë, kombit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjeve politike, gjendjes sociale, orientimit seksual, shkallës së aftësive fizike dhe mendore, statusit familjar dhe moshës. Neni 5.1.2 Ministria, përpilon politika dhe zbaton ligjet e një sistemi jo-diskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor të bazuara në analiza profesionale dhe të dhëna shkencore. Neni 8.1
Institucionet e përfshira drejtpërdrejt	Ministria e Shëndetsisë
Metoda e zbatimit	E drejtpërdrejtë
Efekti i përfshuar	I drejtpërdrejt
Niveli i legjisacionit	Vendor [I brendshëm]
Burimi i informacionit dhe gjuha	<u>Gazeta Zyrtare nr. 13/2013</u> Shqip, English, Srpski

## X.i Burime ndihmëse

Për çdo të lexues/e që është i/e interesuar të mësojë më shumë mbi legjislacionin vendor dhe lidhjen e tij me barazinë gjinore, ose për të kuptuar më qartë konceptet mbi gjininë, barazinë, buxhetimin gjinor etj., rekomandojmë edhe leximin e komentarëve të ligjeve për barazi gjinore, dhe atij kundër dhunës në familje. Qëllimi i këtyre komentarëve është sqarimi i paqartësive të mundshme në kuptimin dhe zbatimin e normave dhe standarteve që promovojnë. Të dy ligjet kanë një veçanti: kanë lidhshmëri me një numër të madh ligjesh dhe sektorësh të veçantë. Komentimi është bazuar në sqarimin e kuptimit të normës nga vetë përmbajtja e saj, në lidhshmëri me normat (nenet) e tjera të vetë ligjit, në lidhshmëri me ligjet e tjera, veçanërisht me praktikën e deritashme gjyqësore, duke i dhënë kuptimin një nen i caktuar rreth asaj se si mund të zbatohet në praktikë. Shpjegimi është mbështetur edhe në literaturë dhe raporte të organizatave vendore dhe ndërkombëtare. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar komentimit në lidhshmëri me direktivat e BE-së lidhur me të drejtat e njeriut dhe trajtimin e barabartë të gjinive, direktiva këto që janë edhe pjesë e këtij ligji.



## **IX. Legjislacioni ndërkombe tar mbi të drejtat e grave dhe barazinë gjinore**

Neni 19 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton qartë se:

1. Marrëveshjet ndërkombe tarare të ratifikuar nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazeten Zyrtare të Republikës së Kosovës. Atozbatojen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerjen e një ligji.
2. Marrëveshjet ndërkombe tarare të ratifikuar dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombe tarare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

Barazia gjinore është një e drejtë themelore dhe një vlerë e përbashkët e vendeve të BE-së. Me synimin e integrimit në BE, barazia gjinore është një kusht i domosdoshëm për hyrjen e Kosovës në të dhe kërkohet për plotësimin e objektivave të MSA-së për punësimin dhe kohezionin social, të cilat janë pjesë e *acquis communautaire*.

Ndërsa për qëllimin e këtij publikimi, Neni 22 i Kushtetutës na ndihmon më shumë:

[cit.] ‘Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombe tarare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:...’ Neni 22 vijon me renditjen e marrëveshjeve dhe instrumenteve të rëndësishme të së drejtës ndërkombe tarare, por duke respektuar dy nocionet domethënëse përse merr jetë ky publikim i.e. ‘barazi’ dhe ‘gjini’ më poshtëështë një përshkrim i përbledhur i dy konventave, normat e të cilave [mbi barazinë gjinore, por jo vetëm] zbatohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

Konventa europiane për të drejtat e njeriut(KEDNJ) Parimi i barazisë gjinore është një nga parimet themelore të ligjit të të drejtave të njeriut. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut vazhdimesht është shprehur se “barazia e sekseve është një nga qëllimet madhore të Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës”, dhe kohët e fundit e ka deklaruar barazinë gjinore si një nga parimet themelore, thelbësore të Konventës. Neni 14 i KEDNJ-së është dispozita bazë kundër diskriminimit. Në të përcaktohet se: ‘Gëzimi i të drejtave dhe lirive tëparashikuara në këtë Konventë, do të sigurohet pa diskriminim, për çdo lloj arsyje si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politikapo të tjera, origjina kombëtare apo sociale, të shoqëruarit me statusin e pakicëskombëtare, pronës, lindjes, apo ndonjë status tjetër’ (Neni 14 i KEDNJ-së – Ndalimi i Diskriminimit).

Edhe Neni 5 i Protokollit Nr. 7 të KEDNJ-së përmend shprehimisht barazinë: ‘Bashkëshortët do të gëzojnë barazi të drejtash dhe përgjegjësisht të karakterit të sëdrejtës private midis tyre dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe në rastin e zgjidhjes së saj. Ky nen nuk do t'i ndalojë Shtetet që të marrin masa të nevojshme në interesin e fëmijëve (Neni 5 – Barazia midis bashkëshortëve).

Në Protokolin nr.12 të KEDNJ-së mbrojtja nga diskriminimi sipas Nenit 14, është plotësuar në Nenin 1 të këtij Protokolli. Protokolli 12 e zgjeron gamën e zbatimit të Nenit 14, duke parashikuar një zbatim krejtësisht të pavarurtë parimit të mos-diskriminimit “për çdo të drejtë të përcaktuarme ligj”. Ky protokoll veçanërisht zgjeron gamën e mbrojtjes nga mosdiskriminimi përfshirë të përfshirë detyrimin negative


të palëvekontraktuese si edhe një detyrim pozitiv (për të marrë masa për mbrojtje nga diskriminimi, edhe A kur diskriminimi ndodh midis palëve private). Ai qëndron pranë Nenit 14, pa e ndryshuar apo shfuqizuar atë. Megjithatë, sikurse Neni 14, ai nuk garanton mosdiskriminim në terma absolute. Përkundrazi, ai ndjek përqasjen e miratuar nga GjEDNj-ja në juridiksionin e saj. Protokolli 12 i KEDNj -së garanton një të drejtë që qëndron më vete (për barazinë). Ai shprehet: 'Gëzimi i një të drejte të parashikuar me ligj do të sigurohet pa diskriminim për asnjë shkak të tillë si, seksi, raca, ngjyra, feja, mendimi politik apo ndonjë mendim tjetër, origjina kombëtareapo shoqërore, lidhja me një pakicë kombëtare, pronë, lindjeapo ndonjë status tjetër. Askush nuk duhet të diskriminohet nga ndonjë autoritet public për shkaqe të tillë si ato që përmenden në paragafin 1. (Neni 1 – Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit).

#### Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW)

Në bazë të nenit 22 të Kushtetutës së saj, Kosova veç KEDNJsë dhe traktateve të tjera është ligjërisht e detyruar që dispozitat e Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) t'i zbatojnë praktikë dhe të shkojë përtej barazisë "de jure" dhe të sigurojëbarazi rezultatesh.

Është me shumë rëndësi që të gjithë shtetasit, dhe në veçanti, nëpunësit, juristët, avokatët, prokurorët dhe gjykatësit t'i njohin instrumentet e të drejtës ndërkontinentare. Por nuk mjafton vetëm njohja e tyre nëse nuk i zbatojmë siç duhet këto instrumente gjatë kryerjes së punëve tona të përditshme. Në këtë pikë, është me dobi të konsiderojmë rekomandimet e mëposhtme gjatë përdorimit apo zbatimit të normave tëCEDAW:

- Zbatim i drejtpërdrejtë i dispozitave të vetë-zbatueshme të CEDAW-t: Kjo do të thotë se rregullat e CEDAW-t janërregullat kryesore, që duhen ndjekur gjatë gjykimit të çështjeve gjyqësore. Zbatimi i drejtpërdrejtë i CEDAW-t bën të mundur të hidhet poshtë një ligi kombëtar i një rendi më të ulët (shih Nenin 22 të Kushtetutës);
- Interpretimi i ligjeve vendore (të brendshme) në dritën e standardeve të CEDAW-t: Referimi tek CEDAW me qëllim që të mbështetet njëzgjidhje e bazuar në të drejtën e vendit. Një çështje zgjidhet vetëm në bazë të së drejtës së vendit, duke iu referuar edhe CEDAW-t për të theksuar natyrën themelore të parimit apo të drejtës, të njohur ndërkokë edhe nga e drejta e vendit.
- Standardet e CEDAW-t janë të rëndësishme për përcaktimin nga një gjykatës të një parimi të mbështetur tek CEDAW: Ka një opsjon dhe praktikë, e cila është gati duke u kristalizuar, në lidhje me rëndësinë e precedentit juridik si burim drejtësie, edhe në vende që zbatojnë të drejtën kontinentale (sisteme të myllura apo të kodifikuara).



## X. Koncepte dhe përkufizime të nevojshme

**Barazi gjinore** do të thotë se të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e personalitetit të tyre dhe të bëjnë zgjedhje pa kufizime të vendosura nga stereotipat, rolet e ngurta gjinore apo paragjykimet. Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë [2015] jep këtë shpjegim për nocionin ‘barazi gjinore’: ... ushtrimi i plotë dhe i barabartë i femrave dhe meshkujve i të drejtave të tyre të njeriut. Është mosprania e diskriminimit në bazë gjinore në mundësitet, ndarjen e burimeve apo përfitimeve si dhe qasjen në shërbime; [Neni 3.1.1]

**Analiza gjinore** është një mënyrë sistematike e të parit të ndikimeve të ndryshme të zhvillimit, politikave, programeve dhe ligjeve te gratë dhe burrat, e cila kërkon: pikësëpari, mbledhjen e të dhënave të ndara sipas seksit dhe informacion të ndjeshëm ndaj gjinisë në lidhje me popullsinë në fjalë. Analiza gjinore mund të përfshijë shqyrtimin e mënyrave të shumëfishta me të cilat grata dhe burrat, si aktorë shoqërorë, angazhohen në strategji për të transformuar rolet ekzistuese, marrëdhëniet dhe proceset në interesin e tyre dhe në interesin e të tjerëve.

**Baza ligjore e aplikueshme:** Kur një person është i punësuar nga një punëdhënës, i cili, është i vendosur ligjërisht në një vend, por ai ose ajo punon në një tjetër vend ose vende, atëherë baza ligjore e aplikueshme është ligji i atij vendi ku personi është i siguruar, psh. i vendit ku ai paguan kontributet e sigurimeve shoqërore (dhe taksat), dhe nga i cili (ose në të cilin) ai ka të drejtën të përfitojë kompensime sociale. Një parim që përshkon dhe nënvízohet në të drejtën evropiane

është së në rastin e secilit individ, vetëm ligji i një vendi është i aplikueshëm.

**Buxhetimi gjinor (BGj)** është zbatimi i përfshirjes së këndvështrimit gjinor në procesin e hartimit të buxhetit. Ai do të thotë vlerësim i mbështetur në gjini i buxheteve, duke përfshirë një perspective gjinore në proceset buxhetore dhe ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim nxitjen e barazisë gjinore. Buxhetimi gjinor ka të bëjë me shqyrtimin e rezultateve gjinore të shpërndarjes së parave në buxhet, që do të thotë sësi shpërndarjet e parave ndikojnë në mundësitet sociale dhe ekonomike të burrave dhe grave. Rishpërndarjet e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe ristrukturimi i procesit buxhetor mund të janë të nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.

**Dallimi gjinor në pagë**. Pavarësisht nga njoftja e të drejtës, hendeku i pagave midis grave dhe burrave, i matur si “dallim relativ në fitimet mesatare bruto për orë midis grave dhe burrave”, tani vlerësohet se është 16.2% në disavantazh të grave, në Bashkimin European (EC 2016). I matur në bazë të ciklit jetësor dhe jo të fitimeve për orë, hendeku i pagave bëhet akoma dhe më i madh, duke shpjeguar feminizmin e varfërisë - në veçanti për nënët e vetme dhe gratë në moshë të vjetër. Zakonisht paraqiten disa faktorë për të shpjeguar hendekun e pagave midis grave dhe burrave: ndarja gjinore horizontale e vertikale në tregun e punës (që zakonisht përmendet si “muret prej xhami” dhe “tavanet prej xhami”), kualifikimet dhe përvoja më e pakët e supozuar e grave dhe orët e tyre jo të zakonshme të punës dhe strukturat jo të zakonshme të karrierës së tyre për shkak

të lindjes e kujdesit të fëmijëve. Megjithatë, mbi gjysma e hendekut gjinor tipik të pagave nuk mund të shpjegohet objektivisht përmes faktorëve të tillë “strukturorë” dhe në të vërtetë shkaktohet nga diskriminimi i gjatë ndaj grave: nga dallimet në mundësitet e tyre për të ndjekur arsimin, trajnimet dhe nga vetë tregu i punës, nga vlerësimi i paragjykuar, nga sistemet e pagës dhe prej ngritjes në detyrë, si dhe nga stereotipat diskriminues gjinorë dhe rolet e vjetruara gjinore themelore për pagë të barabartë për punë të barabartë.

**Dialogu social:** Të gjitha format e negocimit, konsultimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet partnerëve socialë (dialogu dypalësh), si dhe ndërmjet partnerëve socialë nga njëra anë dhe përfaqësuesve të qeverisë nga ana tjeter (dialogu trepalësh), mbi çështje me interes të përbashkët si psh. Politikat sociale dhe ekonomike. Përfshirja e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile në procesin e vendim-marrjes çon në mirëkuptim publik më të plotë dhe në një mbështetje më të madhe të publikut për masat dhe politikat sociale dhe ekonomike të ndërmarra.

**Diskriminim i drejtpërdrejtë/jo i drejtpërdrejtë:** Diskriminim i drejtpërdrejtë ndodh kur një përsone, si psh një i punësuar ose në process punësimi, është me pak i favorizuar mbi baza të racës, seksit, statusit martesor, besimit, orientimit seksual, ose përcaktimit gjinor. Diskriminim i drejtpërdrejtë gjinor do të thotë trajtim i pabarabartë i çdo individu ne raport me një individ të gjinisë së kundërt, në rrethana të njëjtë apo të ngjashme.

Diskriminim i tërthortë ose jo i drejtpërdrejtë është vënia e individit të njërsës gjini në një pozitë jo të barabartë me

dispozita/standard/rrethana asnjëanëse; apo trajtim pabarabartë në rrethana të njëjtë apo të ngjashme perveç rasteve kur këto dispozita apo ky trajtim është i domosdoshëm dhe justifikohet për faktë objective në lidhje me njëren prej gjinive.

Diskriminim jo i drejtpërdrejtë ndodh kur efektet e disa kërkesave, kushtet ose praktikat e vendosura nga shteti, institucioni ose dhe një punëdhënës kanë një efekt jo të dëshirueshëm për një grup të vecantë ose kategori njerëzish.

**Diskriminim me bazë gjinore** do të thotë që vajzat dhe gratë nuk kanë të njëjtat mundësi si burrat për arsim, karriera të rëndësishme, ndikim politik dhe përparim ekonomik. Gjithashtu, kur gratë dhe burrat kryejnë të njëjtat detyra përkundrejt pagesës, gratë shpesh paguhen më pak dhe marrin më pak përfitime për punën e tyre, sesa burrat.

**Drejtësia gjinore** do të thotë se gratë dhe burrat trajtohen me drejtësi, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë apo trajtim të ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm nga pikëpamja e të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, qëllimi i drejtësisë gjinore shpesh kërkon përfshirjen në të të masave për të kompensuar disavantazhet historike dhe shoqërore të grave.

**Drejtësia sociale:** Lidhet me mënyrën në të cilën burimet dhe shanset shpërndahen për individët dhe grupet shoqërore. Kriteret kryesore të drejtësisë sociale janë: ligji, meritat dhe nevojat. Përceptimi se cfarë kërkon (si kuptohet) drejtësia sociale, mund të ndryshojë nga

një shoqëri në tjetrën por dhe brenda vetë grupeve të njerëzve të një shoqërie të caktuar. Drejtësia shoqërore është një qëllim i zhvillimit të qëndrueshëm njerëzor. I referohet situatës së drejtësisë dhe barazisë në trajtimin e të gjithë njerëzve. Është konkretisht "shoqërore", meqenëse i referohet jo vetëm barazisë përpara ligjit, por edhe trajtimit të drejtë në praktikë. Sipas drejtësisë shoqërore, njerëzit dha mireqenia e tyre ka përparësi ndaj problemeve të tjera (ekonomike). Barazia gjinore është një përbërës i rëndësishëm dhe i përcaktuar i drejtësisë shoqërore. Drejtësia shoqërore nuk ekziston nëse burrat apo gratë diskriminohen.

**Dhuna me bazë gjinore (DhBGj)** është një term i përgjithshëm për çdo të keqe të shkaktuar kundër dëshirës së një personi; e cila ka ndikim negativ ndaj shëndetit fizik apo psikologjik, zhvillimit dhe identitetit të personit; dhe që është rezultat i marrëdhënieve gjinore të pushtetit, të cilat shfrytëzojnë pabarazitë dhe varësinë midis grave dhe burrave. Pavarësisht se nuk vlen vetëm për gratë dhe vajzat, DhBGj ja kryesisht i prek ato në të gjitha kulturat. Dhuna mund të jetë fizike, seksuale, psikologjike, ekonomike ose social-kulturore. Kategoritë e autorëve mund të përfshijnë anëtarë të familjes, pjesëtarë të komunitetit, dhe atë që veprojnë në emër të apo duke mos përfillur institucionet kulturore, fetare, shtetërore, apo ndërshtetërorë.

**Dhuna ndaj grave** përcaktohet në nenin 1 të Deklaratës për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (1993). Termi i referohet "çdo akti dhune me bazë gjininë, i cili sjell për pasojë, apo ka të ngjarë të sjellë për pasojë, dëmtim fizik, seksual, psikologjik apo vuajtje për gratë,

duke përfshirë kërcënime për akte të tillë, shtrëngim apo heqje arbitrale të lirisë, qoftë në jetën publike apo atë private".

**E drejta:** Titull ligjërisht i zbatueshëm dhe moralisht i justifikuar që u jepet përsonave fizikë dhe juridik, për të ndërmarrë disa veprime, ose për t'u përbajtur nga disa veprime në lidhje më një përsone tjetër ose përsone të tjera; ose në lidhje me disa mallra dhe sherbime, respektivisht në lidhje me rezultatet ligjërisht të detyrueshme ose moralisht të justifikuara për të "përfituar" ose për të "mos përfituar" disa aktivitete dhe mallra nga persona të tjera. Kështu ligji për familjen u akordon prindërve të drejtë të ndërmarrë veprime në lidhje me fëmijët e tyre. Kemi dy lloj të drejtash: të drejtat negative (e drejta për të bërë diçka pa ndërhyrjen ose përzierjen e njerëzve të tjera); dhe e drejta pozitive (e drejta që i detyron të tjera të përbërë diçka për ne, si psh. për të na ndihmuar). Disa të drejta u përkasin njerëzve thjesht si qënie njerëzore (të drejtat njerëzore), disa të drejta u përkasin njerëzve thjesht se janë qytetarë të një shteti ose anëtarë të një shoqate politike, ekonomike apo sociale, (të drejtat ligjore), ndërsa disa të drejta të tjera bazohen në pranimin e disa parimeve morale (të drejtat morale). Në politikat sociale legjitimiteti i të drejtave në më të shumtën e rasteve rrjedh nga dy burime: nevojat dhe meritat.

**Fuqizimi i grave :** Proces nga "poshtë-lart" për transformimin e marrëdhënieve të pushtetit gjinor përmes individëve apo grupeve që punojnë për ndërgjegjësimin në lidhje me varësinë e grave dhe krijimin e kapaciteteve të tyre për ta kundërshtuar atë.

**Fuqizimi** nënkupton njerëz - burra dhe gra - që marrin në dorë kontrollin e jetës së tyre: bëjnë vetë programin e tyre, përftojnë aftesi (apo bëjnë që t'u njihen aftësitë dhe njohuritë e tyre), rrisin vetëbesimin, zgjidhin problemet dhe krijojnë mbështetje në vete. Ai është njëherazi proces dhe rezultat. Fuqizimi nënkupton zgjerimin e aftësive të grave për të bërë zgjedhje strategjike në jetë, në një kontekst ku më parë aftësia u është mohuar.

**Gjinia** ka të bëjë me një mori rolesh dhe marrëdhënie shëtësore ndërtuara shoqërisht, me tipare të personalitetit, qëndrime, sjellje, vlera, pushtet relativ dhe ndikim që shoqëria ua atribuon dy sekseve në baza të ndryshme. Ndërsa seksi biologjik përcaktohet nga veçori gjenetike dhe anatomike, gjinia është një identitet i përfthuar, i cili mësohet, ndryshon me kohë dhe është shumë i ndryshëm në kultura të ndryshme. Gjinia lidhet me marrëdhëniat dhe nuk ka të bëjë thjesht me gratë apo burrat, por me marrëdhëniat midis tyre.

**I verbër [I pandjeshëm] ndaj gjinisë:** Një person, politikë, apo institucion që nuk pranon se gjinia është një përcaktues vendimtar në zgjedhjet e jetës dhe në mundësitë që ekzistojnë për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në shoqëri.

**Interesa gjinorë strategjikë (IGjS)** identifikohen nga gratë, si rrjedhojë e statusit të tyre të varur shoqëror dhe priren të kundërshtojnë ndarjet gjinore të pushtetit dhe të kontrollit të punës, si dhe normat dhe rolet e përcaktuara tradicionalisht. IGjS-të ndryshojnë në varësi të konteksteve të caktuara dhe mund të përfshijnë çështje të tillë si të drejtat ligjore, dhunën në familje, pagat e barabarta dhe kontrollin nga gratë të trupave të tyre.

**Karta Sociale Evropiane:** Dokumenti bazë mbi të drejtat njerëzore i hartuar nga Këshilli i Evropës. Karta e parë Sociale Evropiane është prezantuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1961 në Torino. Karta Sociale Evropiane e Rishikuar është prezantuar në vitin 1996. Kjo karta njeh tre kategori të të drejtave njerëzore. Kategoria e parë lidhet me të gjithë qytetarët e një vendi, kategoria e dyte lidhet me të drejtat e qytetarëve në fushën e punësimit dhe e tretë mbulon të drejtat e grupeve sociale specifike.

**Koeficienti Gini:** Është instrumenti matës për pabarazinë ekonomike në shoqëri. Vlerat e tij mund të janë nga zero (kur të ardhurat janë të shpërndara në mënyrë të barabartë ndërmjet të gjithë qytetarëve) dhe një (kur një person ka të gjithë të ardhurat kombëtare neto, në dispozicion të tij ose të saj). Sa më afër vlerës 1 të jetë koeficienti, aq më të mëdha janë pabarazitë në mirëqenie në një shoqëri.

**Kohezion social:** Një shoqëri konsiderohet se ka “kohezion social” kur anëtarët e saj, me gjithëse janë me etni të ndryshme, besim tjetër apo prejardhje të ndryshme gjeografike, kanë të përbashkët normat dhe vlerat, respektojnë identitetin e njëri-tjetrit, dhe kur nuk ka dallime të pakapërcyeshme në pasuri dhe në mundësi ekonomike.

**Mbrojtja sociale:** Përfshin të gjithë legislacionin, masat dhe praktikat për të mbrojtur individët nga rreziqet më të shumta të jetës, të tillë si: sëmundjet e tejgjatura ose aksidentet (dëmtimet) dhe rreziqet financiare (kryesisht kostot e trajtimit dhe humbjes së të ardhurave), paaftësia, humbja e punës, fatkeqësitet natyrore, lufta dhe rebelimet, etj., ose për të lehtësuar ndodhitë e tillë për personat e

prekur. Mbrojtja sociale ka pesë komponentë: i. programet dhe politikat e tregut të punës të hartuara në dobi të punësimit dhe nxitjes se veprimeve eficente për tregun e punës; ii. programet e sigurimeve shoqërore për të amortizuar rreziqet që shoqërojnë punësimin, shëndetin, paaftësinë, dëmtimet në punë dhe plakjen; iii. asistencën sociale dhe programet e mirëqënies sociale për grupet më në nevojë dhe me asnje mjet tjetër mbështetës për jetesën e tyre; iv. mikro-skemat dhe skemat e tjera të mbështetura në terren për t'ju adresuar dhe trajtuar nevojat në nivel komunitar; dhe v. mbrojtjen për fëmijët për të siguruar një zhvillim të shëndetshëm dhe produktiv të krahut të ardhshëm të punës.

**Minimumi jetik:** Niveli i të ardhurave nën të cilin individët dhe familjet konsiderohen të varfér. Ka një sërë mënyrash për të përcaktuar minimumin jetik: bazuar në shpenzimet reale për jetesë, ose në një mënyrë relative(si psh. 50% e të ardhurave mesatare; ose 60% e pagës mesatare) që është edhe përcaktimi i Bashkimit Evropian mbi minimumin jetik).

**Ndarja profesionale** është shpërndarja e grupeve, të cilët përcaktohen nga veçori, kryesisht gjinore, që caktohen si përgjatë ashtu dhe brenda profesioneve, industrive dhe firmave. Ndarja profesionale në shumicën e rasteve shkaktohet nga diskriminimi i mbështetur në gjini, i cili bëhet sipas modelevë të caktuara, ose përgjatë profesioneve (horizontalisht) apo brenda hierarkisë së profesioneve (vertikalisht). Të dyja këto forma të ndarjes profesionale e bëjnë këtë fenomen një faktor kryesor të hendekut gjinor të pagave.

**Nevojat praktike gjinore (NPGj)** përcaktohen nga gratë në rolet e tyre shoqërish të përcaktuara, si përgjigje e perceptimit të një nevoje imediate. NPGj-të zakonisht lidhen me pamjaftueshmëritë e kushteve të jetesës të tilla si: sigurimi i furnizimit me ujë, kujdesi shëndetësor dhe punësimi dhe nuk vënë në diskutim ndarjet gjinore në punë dhe pozitën e varur të gruas në shoqëri.

**Partnerët Socialë:** Organizatat e punëmarrësve dhe punëdhënësve të cilat bien dakort për të marrë vendime rrëth çeshtjeve sociale dhe ekonomike, vecanërisht ato që lidhen me kushtet e punës dhe të drejtat e punëtorëve në vendin e punës. Në vendet e Evropës bashkëkohore, partnerët socialë të një vendi sëbashku me përfaqësuesit e qeverisjes, përfundojnë e nënshkruajnë marrëveshje kolektive mbi të gjitha çeshtjet sociale dhe ekonomike që kanë efekte mbi punëtorët.

**Përfitimet e amësise:** Përfitimet që u paguhen rregullisht nënave gjatë periudhës së shtazanisë së tyre, (para dhe pas lindjes), zakonisht një përqindje e caktuar e pagës së saj të mëparshme.

**Përfshirja e këndvështrimit gjinor** është procesi i vlerësimit të implikimeve për gratë dhe burrat i një veprimi të planifikuar, duke përfshirë legjislacionin, politikat ose programet, në çdo fushë dhe në të gjitha nivelet. Ajo është një strategji për bërjen e problemeve dhe përvojave të grave dhe të burrave një dimension integral në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore, me qëllim që të mos përfjetësohet pabarazia midis grave dhe burrave.

**Përfshirja/Integrimi gjinor/e:** (Ri)organizimi, përmirësimi dhe vlerësimi i të gjitha proceseve politike për të ofruar barazinë gjinore në të gjithë nivelet dhe në të gjitha fushat e jetës publike. Me një vendim të Këshillit Evropian të vitit 1994, nxitja dhe promovimi i mundësive të barabarta, gjithashtu ndërmjet burrave dhe grave, u vendos si një prioritet për Bashkimin Evropian dhe shtetet anëtare. Qysh në këtë kohë përfshirja dhe trajtimi gjinor ka qënë një nga parimet udhërrëfyes i integruar në të gjitha programet, aktivitetet dhe politikat Evropiane.

**Përfshirja sociale:** Përfshin një sërë programesh dhe masash me qëllim integrimin në “rrjedhën” shoqërore të individëve ose të grupeve të caktuara te popullsisë të përjashtuar nga pikëpamja sociale, (psh. ata që i përkasin minoriteteve etnike). Programe të tilla kombinojnë objektivat sociale dhe ekonomike me masat e marra. Në këtë mënyrë përfitimi i mbështetjes me të ardhura mund të kushtëzohet me pjesëmarrjen aktive në proceset e përfshirjes sociale. Në Francë, janë prezantuar të ashtuquajturat kontrata të përfshirjes sociale, që duhet të firmosen nga njëri prej individëve të grupit të synuar dhe një përfaqësues i shtetit ose administratës lokale, për të rritur ndërgjegjësimin e këtyre individëve mbi përgjegjësinë e tyre në funksion të përfshirjes sociale.

**Përjashtimi social:** Në Bashkimin Evropian “përjashtimi social” kuptohet si një paaftësi dhe mos dëshirë pér të integruar disa kategori njërzish në rrymën e aktiviteteve social ekonomike të komunitetit ku jetojnë. Koncepti, i pranuar si i tillë, është më i gjërë së ai i varfërisë, sepse ai përfshin gjithashtu privacionin social dhe moral, që është pasojë e mungesës së solidaritetit dhe lidhjeve ndërmjet

individëve në shoqëri. Përjashtimi Social është e kundërtë e Kohezionit Social.

**Pikëpamja gjinore** apo “thjerrzat gjinore” mund të përcaktohet si një fokus që sjell një kuadër analize, me qëllimin për të vlerësuar sesi gratë dhe burrat ndikojnë dhe ndikohen ndryshe nga politikat, programet, projektet dhe veprimtaritet. Ajo mundëson pranimin se marrëdhëniet midis grave dhe burrave mund të ndryshojnë në varësi të kontekstit. Një perspektivë gjinore merr parasysh rolet gjinore e marrëdhëniet dhe nevojat shoqërore e ekonomike, qasjen në burime dhe kufizimet e mundësítë e tjera, që imponohen nga shoqëria apo kultura, mosha, feja dhe\ose prejardhja etnike ndaj grave dhe burrave.

**Politika neutrale ndaj gjinisë, të ndjeshme ndaj gjinisë, dhe transformuese të gjinisë.** Qëllimi parësor i përfshirjes së këndvështrimit gjinor është të hartojë dhe zbatojë projekte zhvillimore, programe, dhe politika që: (i) nuk përforcojnë pabarazitë ekzistuese gjinore (neutrale ndaj gjinisë); (ii) përpilen të trajtonë pabarazitë ekzistuese gjinore (të ndjeshëm ndaj gjinisë); dhe (iii) përpilen të ripërcaktojnë rolet dhe marrëdhëniet gjinore të grave dhe burrave (pozitive/transformuese të gjinisë). Shkalla e integrimit të perspektivës gjinore në çdo projekt të caktuar mund të shihet si një etërë.

**Puna e papaguar:** Puna për të cilën një individ nuk merr një pagë ose një shpërblim në para. Puna e shtëpisë përgjithësisht është e papaguar, sic është edhe puna e bërë nga anëtarët e familjes në bizneset e vogla familjare ose në fermat e vogla familjare.

**Puna riprodhuese** ka të bëjë me punën në sferën e brendshme apo punë të tjera kujdestarie (për të veglit, të sëmurët, apo të moshuarit). Ajo kryhet kryesisht nga gratë dhe ofrohet pa pagesë apo pa shpresë se do të paguhet, dhe nuk llogaritet si pjesë e produktit bruto të brendshëm të vendit. Megjithatë, ajo siguron ruajtjen e strukturave shoqërore dhe familjare nga të cilat varet **puna prodhuese** (puna për para). Ajo përmendet gjithashtu edhe si riprodhim shoqëror.

**Qeverisja e mirë** është menaxhimi transparent dhe llogaridhënës i burimeve njerëzore, natyrore, ekonomike dhe financiare, me qëllim zhvillimin e barabartë dhe të qëndrueshëm. Në kuadër të një mjedisi politik dhe institucional që mbrojnë drejtat e njeriut, parimet demokratike dhe shtetin ligjor.

**Qytetaria:** Një koncept sociologjik (por edhe ligjor) që luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e politikave sociale. Përkufizimi më dominues i qytetarisëpërbëhet nga tre komponentë: të drejtat civile, (si psh barazinë para ligjit); të drejtat politike (si psh e drejta për të votuar, për t'u organizuar politikisht dhe për të marrë pjesë në jetën publike) dhe të drejtat sociale (si psh e drejta për të ardhurat minimale dhe e drejta për të përfituar sherbime sociale). Këto të drejta formojnë bazën për solidaritet social në shoqëritë moderne.

**Rolet gjinore** janë rolet që u caktohen përkatësisht grave, burrave, vajzave dhe djemve, sipas normave dhe traditave kulturore. Ato ndryshojnë midis shoqërive dhe kulturave, klasave, moshave të ndryshme dhe gjatë periudhave të ndryshme të historisë. Shpesh rolet gjinore nuk mbështeten në imperativë biologjikë apo gjinorë, por më

shumë rezultojnë nga stereotipat dhe supozimet rrreth asaj që gratë, burrat, vajzat dhe djemtë mund dhe duhet të bëjnë. Rolet gjinore bëhen problematike kur një shoqëri i cakton një vlerë më të madhe rolit të njërs gjini - zakonisht burrave.

**Seksi** ka të bëjë me veçoritë biologjike që i përcaktojnë njerëzit si femra dhe meshkuj. Këto grupe veçorish biologjike nuk përjashtojnë njëri-tjetrin, meqenëse ka individë që i kanë të dy grupet e veçorive, por, përgjithësisht, këto veçori i ndajnë njerëzit në femra dhe meshkuj.

**Stereotipet gjinore** rrjedhin nga supozimet (shpesh të vjetruara) rrreth roleve, aftësive dhe cilësive të grave, burrave, vajzave dhe djemve. Ndërsa në disa situata specifike mund të dalë se stereotipa të tillë mbështeten në realitet, stereotipat bëhen problematikë kur supozohet se ata vlejnë në mënyrë universale dhe të detyruar për të gjithë burrat dhe gratë. Kjo mund të shpjerë në bariera material dhe psikologjike të cilat i parandalojnë gratë dhe burrat që të bëjnë zgjedhje dhe të gjelqinë plotësisht të drejtat e tyre.

**Mundësitë e barabarta:** Është një parim i përgjithshëm që nën vizohet në sistemet ligjore si psh të Evropës dhe SHBA-së, i aplikueshem në fushën ekonomike, sociale dhe në jetën kulturore, sipas të cilit të gjithë qytëtarëve u ofrohen mundësi të barabarta për sukses kur ato konkurojnë për pozicione dhe të mira materiale publike të vlefshme. Ky parim nënkupton sigurimin e pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha aspektet e jetës politike, sociale, kulturore arsimore ekonomike dhe fushat tjera.

Përveçse barazisë përpara ligjit, aksesi i njejtë për tu arsimuar është i një rëndësie të veçantë në rendjen drejt shoqerive egalitariane.

**Të drejtat e grave:** Të drejtat e grave dhe fëmijëve vajza, si një pjesë e patjetërsueshme, integrale dhe e pandashme e të drejtave njerëzore universale.

**Të drejtat njerëzore sociale-ekonomike dhe politike:** Të drejtat politike të njeriut janë të sanksionuara në instrumentat ligjore të: a) Kombave të Bashkuara, të tilla si: Konventa mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimtit të Genocidit të vitit 1948, Konventa lidhur me Statusin e Refugjatëve e vitit 1951, Konventa lidhur me të Drejtat Politike të Grave e vitit 1953, etj; b) të Këshillit të Evropës, të tilla si: Konventa mbi Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Themelore, e cili hyri në fuqi në vitin 1953, si dhe instrumenta të organizmave të tjera ndërkombëtare. Tashmë përgjithësisht pranohet së përveçse të drejtave politike bazë të njeriut, si për shembull mosarrestimi në mënyre arbitrale, liria e shprehjes dhe organizimit në shoqata, ka edhe të drejta ekonomike bazë të njeriut të tilla si marrja e kujdesit mjekësor kur ai është i nevojshëm, liria e zgjedhjes së punës dhe e drejta për një pagë të drejtë për punën e kryer. Instrumentat ligjore të Këshillit të Evropës, ILO/ONP dhe BE dhe të organizmave të tjera ndërkombëtarë mbrojnë të drejtat sociale dhe ekonomike të njeriut.

**Tërësia ligjore e BE:** (Gjithashtu i njohur si Acquis communautaire) është tërësia e dokumentave ku përshkruhen rregullat e BE, rregulloret dhe standartet, në të cilat aderojnë të gjitha vendet anëtare, dhe ku vendet aspirante për tu bërë antëtarë, u kërkohet që ti adoptojnë dhe përfshijnë në ligjet dhe praktikat e tyre administrative.

**Tregues i ndjeshëm gjinor.** Ky mund të jetë një matje, një numër, një fakt, një opinion, apo një perceptim, i cili përqendrohet në një kusht apo situatë specifike dhe mat ndryshimet e atij kushti apo situate me kalimin e kohës. Diferenca midis një treguesi dhe një statistike është se treguesi duhet të përfshijë krahasimin me një normë. Treguesit e ndjeshëm gjinorë masin ndryshimet që lidhen me gjininë në shoqëri me kalimin e kohës; duke siguruar një vështrim të kujdesshëm të rezultateve të iniciativave dhe veprimeve të synuara me bazë gjininë.

\*\*

## Referenca

Agjencia per Barazi Gjinore; Ligji per Barazi Gjinore <https://abgj.rks-gov.net/Portals/0/LIGJI%20I%20RI%20P%C3%8BR%20BARAZI%20GJINORE%20shqip.pdf>

Agjencia per barazi Gjinore : Përkufizimet dhe koncepete gjinore <https://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Perkufizimet%20dhe%20konceptet%20gjinore.pdf>

Agjencia për Barazi Gjinore (2011). Gratë në procesin e punës dhe vendimmarjes në Kosovë.

Agjencia për Barazi Gjinore (2014). Plani i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Agjencia për Barazi Gjinore (2014). Raporti i hulumtimit Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore, lokale, dhe në partitë politike në Kosovë, Prishtinë, Kosovë.

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (1948). 217 A (III). Deklarata universale për të drejtat e njëriut.

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (1952). 640 (VII). Konventa për të drejtat politike të grave.

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (1966). 2200 (XXI). Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe police dhe

Protokoli Zgjedhor i Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike.

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (2011). Rezoluta 66/130 Gratë dhe pjesëmarrja politike.

ECOSOC (1990). Rezoluta E/RES/1990/15.

Këshilli Evropian (2015). Përfundime për Planin e Veprimit Gjinor 2016-2020.

Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave (2003) Rekomandim.

Këshilli i Evropës (2014) Strategjia për Barazi Gjinore (2014-2017).

Këshilli i Komunave dhe Rajoneve Evropiane (2006). Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Shoqërore.

Katalogimi në botim  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

305-055.2(496.51)(048)  
305-055.1(496.51)(048)

Çfarë duhet të dimë për barazinë gjinore në  
Kosovë? / Agjencia për Barazi Gjinore. – Prishtinë  
: Agjencia për Barazi Gjinore, 2018. – 43 f. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-545-14-3



108009739951545-143

Digitized by  
Hankinsoft